

MARRËVESHJE LICENCIMI E NORTON

E RËNDËSISHME: LEXONI ME KUJDES KUSHTET E KËSAJ MARRËVESHJEJE LICENCIMI ("MARRËVESHJA E LICENCIMIT") PËRPARA SE TË PËRDORNI SOFTUERIN (SIÇ PËRCAKTOHEN MË POSHTË). SYMANTEC CORPORATION DHE/OSE FILIALET E SAJ QË JANË LICENCUESE TË AUTORIZUARA ("SYMANTEC") ËSHTË E GATSHME T'JU LICENCOJË SOFTUERIN NË CILËSINË TUAJ SI INDIVID, KOMPANI OSE SUBJEKT JURIDIK QË DO TË SHFRYTËZONI SOFTUERIN (PËRMENDUR MË POSHTË SI "JU", "JUAJ", "TUAJ") ME KUSHTIN E VETËM QË TË PRANONI TË GJITHA KUSHTET E KËSAJ MARRËVESHJEJE LICENCIMI. KJO KONTRATË ËSHTË E LIGJSHME DHE ZBATUESHME MIDIS JUSH DHE SYMANTEC. ME HAPJEN E KËSAJ PAKETE, GRISJEN E IZOLIMIT, SHTYPJEN E BUTONIT "PRANOJ" OSE "PO", APO FORMAVE TË TJERA TË PËRCAKTUARA TË PRANIMIT ME MJETE ELEKTRONIKE, APO NGARKIMIT TË SOFTUERIT, APO PËRNDRYSHJE PËRDORIMIT TË SOFTUERIT, JU BINI DAKORD ME KUSHTET E KËSAJ MARRËVESHJEJE LICENCIMI. NËSE NUK BINI DAKORD ME KËTO KUSHTE, SHTYPNI BUTONIN "ANULO" OSE "JO", OSE "MBYLL DRITAREN" APO FORMA TË TJERA PËRKATËSE ME TË CILAT TREGOHET REFUZIMI, MOS E PËRDORNI MË TEJ SOFTUERIN DHE KONTAKTONI (i) ME SHITËSIN OSE ME SHËRBIMIN E SYMANTEC PËR KLIENTËT, SIPAS TË DHËNAVE TË KONTAKTIT TË SEKSIONIT 7 TË KËSAJ MARRËVESHJEJE LICENCIMI, PËR INFORMACION MBI RIMBURSIMIN E SHUMËS QË KENI PAGUAR PËR PERIUHDËN E SHËRBIMIT AKTUAL (TË PËRCAKTUAR MË POSHTË) (DUKE ZBRITUR TRANSPORTIN, MENAXHIMIN DHE ÇDO TAKSË TË VLEFSHME PËRVEÇSE NË SHTETE DHE VENDE TË CAKTUARA KU TRANSPORTI, MENAXHIMI DHE TAKSAT JANË TË RIMBURSUESHME) NË ÇDO KOHË GJATË PERIUHDËS PREJ GJASHTËDHJETË (60) DITËSH PAS DATËS SË BLERJES SË ABONIMIT VJETOR OSE BRENDA TRIDHJETË (30) DITËVE PAS DATËS SË BLERJES SË ABONIMIT MUJOR, OSE (ii) ME OFRUESIN (SIÇ PËRCAKTOHET MË POSHTË) PËR INFORMACION SE SI TË MERRNI RIMBURSIM NËSE E KENI MARRË SOFTUERIN NGA OFRUESI JUAJ.

1. Licenca:

Softueri dhe dokumentacioni kryesor (duke përfshirë paketimin e mundshëm të produktit) (këtu "dokumentacioni kryesor"), që shoqëron këtë marrëveshje licencimi (së bashku këtu "softueri") është pronë e Symantec ose e licencuesve të saj, dhe mbrohet nga ligji për të drejtat e autorit. Ndonëse Symantec apo licencuesit e saj vijojnë të ruajnë pronësinë mbi softuerin, pas pranimit të kësaj marrëveshjeje licencimi do të gëzoni disa të drejta të caktuara për të përdorur softuerin gjatë periudhës së licencës (siç përcaktohet më poshtë). Të gjitha të drejtat që nuk ju përcaktohen shprehimisht i mbeten Symantec dhe/ose licencuesve të saj. "Periudha e licencës" fillon (a) në datën e instalimit apo të përdorimit të parë të softuerit nga ana juaj në kompjuter, mjedis virtual, pajisje celulare apo kompjuterike portative, (këtu "pajisje"), ose (b) në datën që e pranuat këtë marrëveshje licencimi, ose (c) nëse e keni blerë softuerin nga dyqani në internet i Norton, data e kryerjes së blerjes suaj, ose (d) nëse e keni marrë softuerin si pjesë oferte për disa produkte, në datën e kryerjes së blerjes suaj për një ofertë të tillë me shumë produkte, ose (d) nëse i keni marrë të drejtat për përdorimin e softuerit siç përshkruhet në këtë marrëveshje licencimi nga ofruesi i autorizuar i Symantec (këtu "ofruesi"), në datën e përcaktuar nga ky ofrues. Periudha e licencimit zgjat për periudhën e përcaktuar në dokumentacionin kryesor ose në dokumentacionin përkatës të transaksionit nga distributori, rishitësi apo ofruesi i autorizuar nga i cili keni marrë softuerin. Softueri mund të çaktivizohet automatikisht dhe të bëhet jofunksional në fund të periudhës së licencimit dhe ju nuk do të keni më të drejtën të merrni përditësime funksionesh apo përmbytjesh për softuerin nëse nuk rinovoni më parë periudhën e licencimit. Abonimet për rinovime të periudhës së licencimit (i) do të ofrohen në përputhje me rregulloren e mbështetjes teknike të Symantec të publikuar në https://support.norton.com/sp/en/us/home/current/solutions/v74023230_EndUserProfile_en_us ose (ii) do të ofrohen nga ofruesi juaj në përputhje me rregulloret përkatëse të ofruesit, nëse softuerin e keni marrë nga ofruesi juaj.

Kjo marrëveshje licencimi rregullon çdo qarkullim, rishikim, përditësim apo përmirësim të softuerit që mund t'ju ofrojë Symantec. Përveç asaj që mund të modifikohet nga dokumentacioni kryesor, të drejtat dhe detyrimet tuaja të parashikuara në këtë marrëveshje licencimi në lidhje me përdorimin e këtij softueri janë si më poshtë.

Gjatë periudhës së licencimit, mund:

- A. të përdorni një kopje të softuerit në një pajisje të vetme. Nëse përcaktohet numër më i madh kopjesh dhe/ose pajisjesh në dokumentacionin kryesor apo në dokumentacionin përkatës të transaksionit nga distributori, rishitësi apo ofruesi i autorizuar nga i cili keni marrë softuerin, mund ta përdorni softuerin në përputhje me këto specifikime;
- B. të bëni një kopje të softuerit për nevoja rezervimi apo arkivimi, ose të kopjoni softuerin në njësi disku të pajisjes suaj dhe ta mbani origjinalin për nevoja rezervimi apo arkivimi;
- C. të përdorni softuerin në një rrjet, nëse keni kopje të licencuar të softuerit për secilën pajisje që mund të hapë softuerin nëpërmjet rrjetit në fjalë;
- D. të transferoni në formë përfundimtare të gjitha të drejtat tuaja ndaj softuerit, të lëshuara sipas kësaj marrëveshjeje licencimi për një person apo subjekt tjetër, me kusht që të mos mbani asnjë kopje të softuerit dhe pala së cilës i është transferuar bie dakord për të gjitha kushtet e kësaj marrëveshjeje licencimi. Për të evituar dyshimet, nëse softueri që transferohet është pjesë ofertash me disa produkte, duhet t'ia transferoni të gjitha të drejtat për të gjitha ofertat e produkteve të përfshira në këtë softuer. Transferimi i pjesës së drejtave tuaja sipas kësaj marrëveshjeje licencimi nuk lejohet, dhe përpjekje të tilla janë të pavlefshme. Për shembull, nëse dokumentacioni kryesor apo dokumentacioni përkatës i transaksionit nga distributori, rishitësi apo ofruesi i autorizuar ju jep të drejtën të përdorni disa kopje të softuerit ose të drejtën për të instaluar softuerin në disa pajisje, i vlefshëm do të ishte vetëm një transferim i të gjitha të drejtave të përdorimit për të gjitha këto kopje dhe instalime në pajisje për softuerin në fjalë. Për të evituar dyshimet, transferimi i mësipërm i të drejtave nuk vlen nëse softuerin e keni marrë nga ofruesi juaj i shërbimit; dhe
- E. të përdorni softuerin në përputhje me përdorime të mëtejshme që mund të përcaktohen më poshtë.

Softueri është i licencuar për përdorimin tuaj personal dhe jo për ndonjë qëllim tregtar. Blerja e softuerit për qëllim tregtar nuk është e autorizuar.

Nuk ju lejohet, as nuk mund të lejoni të tjerë që:

- A. të nënlicenconi, të jepni me qira apo hua ndonjë pjesë të softuerit;
- B. të shprogramoni, dekompononi, zbërtheni, modifikoni, përktheni, bëni përpjekje për të zbuluar kodin burimor të softuerit ose të krijoni punë derivate nga softueri;
- C. të jepni, ofroni apo vini në dispozicion softuerin si pjesë administrimi ambientesh, ndarjeje të kohës, ofruesi shërbimi apo rregullimi zyre shërbimi; ose
- D. të përdorni softuerin në mënyra që nuk lejohen sipas kësaj Marrëveshjeje licencimi.

Softueri mund të përmbajë veçori dhe funksione të palëve të treta ose mund të hapë përmbajtje në faqe interneti të palëve të treta. Veçori, funksione apo përmbajtje të tilla mund t'u nënshtrohen kushteve të shërbimit dhe rregulloreve të privatësisë së palëve të treta në fjalë.

2. Softueri dhe përditësimet automatike të përmbajtjes:

A. Jo të gjitha versionet, rishikimet, përditësimet, përmirësimet ose veçoritë do të jenë të disponueshme në të gjitha platformat. Ju keni të drejtën të merrni funksione dhe versione të reja të softuerit, ashtu si Symantec, sipas gjykimit të vetëm të saj, i vë në dispozicion këto funksione dhe versione gjatë periudhës suaj të licencimit. Symantec kërkon gjithnjë të përmirësojë përdorimin dhe performancën e produkteve dhe të shërbimeve të veta. Për të përmirësuar softuerin dhe për t'ju dhënë versionin më aktual të softuerit, ju bini dakord që softuerit t'i lejohet të shkarkojë dhe të instalojë përditësime dhe versione të reja të softuerit, ashtu siç këto vihen në dispozicion nga Symantec sipas gjykimit të vetëm të kësaj. Ju pranoni të merrni dhe i lejoni Symantec të dorëzojë përditësime dhe versione të tilla të reja të pajisja juaj. Për më tej, Symantec i lejohet të modifikojë kushtet që vlejné për përdorimin e softuerit nga ana juaj për t'i pasqyruar këto përditësime dhe versione dhe ju bini dakord me këto kushte të përditësuar. Përveçse nëse keni rënë dakord ndryshe me këto ndryshime, kur vijoni me përdorimin e softuerit pas hyrjes në fuqi të modifikimeve, ju bini njëherësh dakord t'u nënshtroheni kushteve të rishikuara.

B. Softuerë të caktuar përdorin përmbajtje që herë pas here përditësohen, duke përfshirë këtu, por pa u kufizuar vetëm në sa më poshtë: softuerët antivirus dhe antikrim përdorin përkufizime të përditësuar të programeve spiune; softuerët antireklamë përdorin filtra të përditësuar antireklamë; softuerët për filtrimin e përmbajtjeve dhe antimashttrim përdorin lista të përditësuar adresash URL; disa softuerë muri mbrojtës përdorin filtra të përditësuar muri mbrojtës; produktet e kontrollit të dobësive përdorin të dhëna të përditësuar për dobësitë dhe softuerët e autentikimit në faqe interneti përdorin lista të përditësuar të faqeve të autentikuara të internetit; këto përditësime përmenden të gjitha bashkë këtu si "përditësime të përmbajtjes". Keni të drejtën të merrni përditësime të përmbajtjes për softuerin dhe shërbimet gjatë periudhës suaj të licencimit.

3. Instalimi i produktit; Domosdoshmëria e aktivizimit;
Llogaria në Norton:

A. Gjatë procesit të instalimit, softueri mund të çinstalohet apo çaktivizohet produkte të tjera sigurie, apo funksione të tjera të këtyre produkteve, nëse këto produkte apo funksione shkaktojnë konflikt me softuerin, ose për qëllime të përmirësimit të funksioneve të përgjithshme të softuerit.

B. Mund të ketë masa teknologjike në këtë softuer që janë krijuar për të parandaluar përdorimin e palicencuar ose të paligjshëm të softuerit. Ju bini dakord që Symantec mund t'i përdorë këtë masa për t'u mbrojtur nga pirateria ndaj softuerit. Ky softuer mund të ketë teknologji detyruese që kufizon mundësinë për instalimin dhe çinstalimin e softuerit në një pajisje deri në një numër të caktuar herësh për një numër të caktuar pajisjesh. Kjo marrëveshje licencimi dhe softueri që përmban teknologjinë detyruese mund të kenë nevojë për aktivizim siç përcaktohet më tej në dokumentacionin kryesor. Në rast të tillë, softueri do të funksionojë për një periudhë të caktuar përpara se të aktivizohet prej jush. Gjatë aktivizimit, mund t'ju kërkohet të jepni kodin tuaj të posaçëm të aktivizimit që shoqëron konfigurimin e softuerit në formë kodi alfanumerik nëpërmjet internetit për të verifikuar autenticitetin e softuerit. Nëse nuk e kryeni aktivizimin brenda kohës së caktuar në dokumentacionin kryesor, apo siç ju kërkohet nga softueri, softueri do të pushojë së funksionuari derisa të kryhet aktivizimi; kohë në të cilën funksionimi i softuerit do të rikthehet. Në rast se nuk keni mundësi të aktivizoni softuerin nëpërmjet internetit ose ndonjë forme tjetër të përcaktuar gjatë procesit të aktivizimit, mund të kontaktoni ose (i) mbështetjen e Symantec për klientët, me informacionin që ju jepet nga Symantec gjatë aktivizimit, ose siç përcaktohet në seksionin 7 më poshtë, ose (ii) ofruesin tuaj, ose subjektin e përcaktuar në dokumentacionin që ju është lëshuar nga ofruesi juaj, nëse e keni marrë softuerin nga ofruesi juaj.

C. Llogaria në Norton. Mund të nevojitet një llogari aktuale në Symantec Norton (këtu "llogaria në Norton") për të hapur dhe përdorur softuerin. Në rast të tillë, nëse nuk keni llogari në Norton, duhet të kryeni procesin përkatës të regjistrimit për të krijuar një llogari në Norton për të përdorur softuerin. Llogaria në Norton mund të mos nevojitet nëse i keni përfituar të drejtat e përdorimit të softuerit nga një ofrues që kërkon të keni llogari tjetër përdoruesi (këtu "llogari ofruesi") për të hapur dhe përdorur softuerin. Shihni dokumentacionin përkatës të transaksionit me ofruesin tuaj për të përcaktuar nëse nevojitet llogari në Norton apo llogari ofruesi për të hapur dhe përdorur softuerin. Ju mbani përgjegjës në plotë për mirëmbajtjen dhe konfidencialitetin e fjalëkalimit tuaj të llogarisë në Norton ose të llogarisë të ofruesit. Përveç kësaj, nëse i transferoni të gjitha të drejtat tuaja në softuer sipas kësaj marrëveshjeje, duhet të hiqni dorë po ashtu nga hyrja ose menaxhimi juaj i çelësit të licencës për softuerin e transferuar nga llogaria juaj në Norton. Kontaktoni me shërbimin e klientit të Symantec ose vizitoni faqen e mbështetjes teknike të Symantec të përcaktuar më poshtë.

4. Detyrimi ndaj klientëve tregtarë:

Nëse jeni konsumator, dispozitat e mëposhtme të këtij seksioni 4 nuk vlejnë për ju, përveçse deri në masën që sipas ligjeve në fuqi në juridiksionin tuaj vlejnë dispozita të caktuara për formën tuaj të përdorimit të softuerit pavarësisht faktit nëse ky përdorim është për qëllime aktiviteti tregtar, zanati apo profesioni. Në vend të këtij lexoni seksionin 5.

Nëse jeni klient tregtar (d.m.th. po e përdorni softuerin në kuadër të një aktiviteti tregtar, zanati apo profesioni (këtu "klient tregtar")), për ju vlejnë dispozitat e mëposhtme të këtij seksioni 4 (pavarësisht nëse e keni pranuar apo jo softuerin).

A. NË MASËN MAKSIMALE TË LEJUAR NGA LEGJISLACIONI NË FUQI, NË ASNJË RAST SYMANTEC APO LICENCUESIT E SAJ NUK KANË DETYRIME NDAJ JUSH (NË RAST NEGLIZHENCE, KONTRATE APO ARSYEJE TJETËR) PËR HUMBJE FITIMESH, TË ARDHURASH, KONTRATASH TREGTARE, KURSIMESH TË PARASHIKUARA APO HUMBJE DHE DËMTIM TË TË DHËNAVE QË MUND TË BUROJNË NGA PËRDORIMI APO PAMUNDËSIA PËR TË PËRDORUR SOFTUERIN OSE PËR ÇFARËDO DËMESH TË POSAÇME, SHKAKËSORE, TËRTHORE APO TË NGJASHME, EDHE NËSE SYMANTEC ËSHTË NJOFTUAR PËR MUNDËSINË E DËMEVE TË TILLA.

B. NË MAKSIMUMIN E PARASHIKUAR NGA LEGJISLACIONI NË FUQI, DETYRIMI I SYMANTEC APO I LICENCUESVE TË SAJ NUK TEJKALON ÇMIMIN E BLERJES QË KENI PAGUAR PËR PERIUdhËN PËRKATËSE TË SHËRBIMIT.

C. Symantec mban përgjegjësi ndaj jush pa kufizime nëse (a) ju vdisni apo lëndoheni për shkak të neglizhencës nga ana e Symantec ose (b) pësoni humbje apo dëmtrim në rast se Symantec vepron në formë mashtruese.

5. Përgjegjësia ndaj konsumatorëve:

Nëse jeni konsumator, ky seksion 5 vlen për ju. Lexojeni me kujdes. Seksioni 4 nuk vlen për ju nëse jeni klient tregtar. Symantec mban përgjegjësi ndaj jush pa kufizime nëse (a) ju vdisni apo lëndoheni për shkak të neglizhencës nga ana e Symantec ose (b) pësoni humbje apo dëmtim në rast se Symantec vepron në formë mashtruese.

A. Sipas dispozitave të mëparshme të këtij seksioni 5, Symantec nuk mban përgjegjësi pagese ndaj jush për çfarëdo humbje që nuk është pasojë logjike dhe parashikueshme e një shkeljeje të kësaj marrëveshjeje licencimi nga ana e Symantec. Si konsumator, përdorimi i softuerit nga ana juaj do të jetë jotregtar. Symantec kështu nuk mban përgjegjësi ndaj jush për çfarëdo humbje të fitimeve, të ardhurave, kursimeve të parashikuara, kontratave apo kohës që buron nga përdorimi apo pamundësia e përdorimit të softuerit në rast të një defekti kryesor.

B. Në çdo kohë do të keni detyrimin të ndërmerri hapa të arsyeshëm për të minimizuar humbjet.

6. Rregullorja e eksportimit:

Ju pranoni se softueri, bashkë me shërbimet dhe të dhënat përkatëse teknike (të gjitha së bashku këtu "teknologji e kontrolluar") mund t'u nënshtrohen ligjeve për import-eksportin të SHBA-së, veçanërisht rregulloreve për administrimin e eksportit të SHBA-së (EAR), dhe ligjeve të cilido shteti ku importohet apo rieksporthet teknologjia e kontrolluar. Ju bini dakord të pajtoheni me të gjitha ligjet përkatëse dhe të mos eksportoni ndonjë teknologji të kontrolluar në shkelje të legjislacionit të SHBA-së, as të ndonjë shteti, subjekti apo personi të ndaluar për të cilat kërkohet licencë eksporti apo miratim qeveritar në formë tjetër. Të gjitha produktet e Symantec ndalohen të eksportohen apo të rieksporthen në Kubë, Kore të Veriut, Iran, Siri dhe Sudan, apo drejt shteteve për të cilat ka sanksione përkatëse tregtare, duke përfshirë Afganistanin dhe Irakun. **PËRDORIMI APO MUNDËSIMI I PRODUKTEVE TË SYMANTEC NË LIDHJE ME AKTIVITETE TË NDRYSHME, DUKE PËRFSHIRË, PA U KUFIZUAR VETËM NË TO, DIZAJNIMIN, ZHVILLIMIN, PRODHIMIN, TRAJNIMIN APO TESTIMIN E MATERIALEVE KIMIKE, BIOLOGJIKE APO BËRTHAMORE, APO TË RAKETAVE, AVIONËVE PA PILOT APO MJETEVE PËR LËSHIME HAPËSINORE QË MUND TË DREJTOJNË ARMË TË SHKATËRRIMIT NË MASË, NDALOHET NË PËRPUTHJE ME LEGJISLACIONIN E SHBA-SË.**

7. Të përgjithshme :

A. Ligji rregullator.

Kjo marrëveshje licencimi rregullohet nga ligjet e Anglisë dhe të Uellsit. Asgjë në këtë marrëveshje licencimi nuk pakëson të drejtat që mund të gëzoni sipas legjislacionit ekzistues për mbrojtjen e konsumatorit apo ligje të tjera në fuqi në juridiksionin tuaj që nuk tërhiqen me kontratë.

B. Marrëveshja e plotë.

Kjo marrëveshje licencimi përbën të gjithë marrëveshjen midis jush dhe Symantec në lidhje me softuerin dhe shërbimet dhe: (i) tejkalon të gjitha komunikimet, propozimet dhe deklaratat e mëparshme apo aktuale verbale apo me shkrim, në lidhje me çështjen në fjalë; dhe (ii) mbizotëron ndaj çdo kushti konfliktual apo shtesë për çmime, porosi, pranime apo komunikime të ngjashme midis palëve. Pavarësisht nga sa më sipër, asgjë në këtë marrëveshje licencimi nuk pakëson të drejtat që mund të gëzoni sipas legjislacionit ekzistues për mbrojtjen e konsumatorit apo ligje të tjera në fuqi në juridiksionin tuaj që nuk tërhiqen me kontratë. Symantec mund ta përfundojë këtë marrëveshje licencimi nëse shkelni ndonjë kusht të kësaj marrëveshjeje licencimi (përtej shkeljeve të papërfillshme apo që nuk kanë pasojë) dhe, nëse ndodh një përfundim i tillë, ju duhet të ndërpriti përdorimin dhe duhet të shkatërroni të gjitha kopjet e softuerit dhe dokumentacionin kryesor. Deklaratat e përgjegjësive për garancitë dhe dëmet e kufizimet për përgjegjësinë vazhdojnë të mbeten në fuqi edhe pas përfundimit.

Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këtë marrëveshje licencimi, ose nëse dëshironi të kontaktoni me Symantec për çfarëdo arsye, shkruani te Symantec Customer Support, PO Box 5689, Dublin 15, Ireland ose vizitoni faqen e mbështetjes teknike të Symantec në www.symantec.com.

KUSHTE TË MËTEJSHME. Përdorimi i softuerit nga ana juaj u nënshtrohet kushteve të mëposhtme përveç atyre të përcaktuara më lart.

8. Privatësia; Mbrojtja e të dhënave:

Nëse softueri ka qenë i instaluar paraprakisht në pajisjen tuaj, kushtet e mëposhtme në shkronja të trashësuar do të jenë të vlefshme për ju:

Gjatë konfigurimit fillestar të pajisjes suaj dhe pas fillimit të përdorimit të produktit tuaj të Norton, Symantec (shikoni detajet e kontaktit më poshtë) dhe produkti juaj i Norton do të mbledhë nga ju të dhënat e mëposhtme:

- Informacionet e abonentit të dhëna nga ju;
- Të dhëna të harduerit, sistemit, aplikacionit dhe lidhjes së rrjetit të mbledhura nga pajisja juaj, duke përfshirë informacionet e statusit për instalimin dhe funksionimin e softuerit të Norton;
- Të dhëna në lidhje me përdorimin e pajisjes dhe të internetit;
- Çdo informacion dhe parametër të kontrollit prindëror që mund të konfiguroni nëse funksione të tilla ofrohen në produktin tuaj të Norton.

Mbledhja e këtyre kategorive të të dhënave është e nevojshme dhe e domosdoshme (a) për të përgatitur konkluzionet e një kontrate mes jush dhe Symantec, dhe (b) për funksionimin e duhur të softuerit të Norton të instaluar paraprakisht në pajisjen tuaj. Të dhënat tuaja do të transferohen tek entet e Symantec dhe furnizuesit e Symantec të përfshirë në lëshimin e çelësit të licencës së përdoruesit fundor dhe dorëzimin e softuerit. Në varësi të kërkesave të zbatueshme dhe, sipas rastit, kërkesave për korrigjim ose fshirje të dorëzuara nga ju, të dhënat e mbledhura do të mbahen nga Symantec për sa kohë që të jetë e nevojshme për plotësimin dhe realizimin e marrëdhënies kontraktuale në fjalë. Ju mund të kontaktoni në çdo kohë me Symantec për të kërkuar hyrjen, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave tuaja personale, dhe nëse dhe kur është e zbatueshme, të merrni kufizimin për përpunimin si objekt i përpunimit të mëtejshëm, ose të merrni mundësinë e lëvizjes. Siç përcaktohet në këtë seksion "Privatësia; Mbrojtja e të dhënave" të kësaj marrëveshjeje, Symantec siguron me anë të mjeteve kontraktuale të autorizuara ligjërisht dhe të marra ligjërisht dhe angazhimeve detyruese korporative se të dhënat tuaja kanë mbrojtje të përshtatshme sa herë që transferohen në shtete ose territore me ligje për mbrojtjen e të dhënave me një nivel më të ulët mbrojtjeje se sa në shtetin ose territorin ku ndodheni ju. Në rast se jeni i pakënaqur me menaxhimin e të dhënave tuaja personale nga Symantec, mund të paraqisni një ankesë pranë Symantec ose, në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, pranë autoritetit mbikëqyrës kompetent. Do të gjeni më shumë detaje për këto të drejta dhe praktikën e Symantec për mbrojtjen e të dhënave në Portalin tonë të privatësisë (<https://www.symantec.com/privacy>) ku mund të hyni në çdo kohë nga çdo pajisje e lidhur në internet.

Për qëllimet e këtij seksioni, referencat ndaj Symantec duhet të kuptohen si më poshtë:

- Për përdoruesit në Amerikë, Symantec Corporation, 350 Ellis Street, P.O. Box 7011 Mountain View, CA 94043 U.S.A., telefoni: +1 650 527 8000, emaili: privacyteam@symantec.com;
- Për përdoruesit në rajonin Evropë-Lindje e Mesme-Afrikë, duke përfshirë shtetet anëtare në BE/ZEE: Symantec Limited, Ballycoolin Business Park, Blanchardstown, Dublin 15, Ireland, telefoni: +353 1 803 5400, emaili: privacyteam@symantec.com (Oficeri për mbrojtjen e të dhënave në BE: Heward Mills, Fitzwilliam Hall, Fitzwilliam Place, Dublin 2, DPO@symantec.com);
- Për përdoruesit në rajonin e Azi-Paqësor-Japoni, Symantec Singapore PTE Limited, 6 Temasek

Kushtet e mëposhtme do të jenë të vlefshme për të gjithë përdoruesit:

Në varësi të parametrave dhe preferencave tuaja të konfigurimit dhe në varësi të ngjarjeve të sigurisë dhe rreziqeve të zbuluara, softueri dhe serverët tanë mund të mbledhin nga pajisja ku ekzekutohet informacione të caktuara, duke përfshirë ndoshta të dhëna personale si:

- Si pjesë e Norton Community Watch, informacionet e pajisjes dhe të produktit, përdorimi i internetit për sa kohë që ka lidhje me softuerët keqdashës dhe faqe ndoshta mashtruese, si dhe proceset dhe aplikacionet në ekzekutim në kohën kur është ndeshur një rrezik sigurie. Kjo mbledhje e të dhënave nuk është e projektuar dhe as nuk ka si synim të mbledhë të dhënat tuaja personale. Symantec nuk do të përpunojë asnjë nga këto të dhëna në një mënyrë ose për një qëllim që kërkon të identifikojë ose që përfshin identifikimin tuaj të qëllimshëm, duke vlerësuar karakteristika personale në lidhje me ju, profilizimin tuaj ose çdo përcaktim të një natyre personale në lidhje me ju. Symantec do të marrë masa të arsyeshme teknike dhe organizative për anonimizimin ose zbulimin e çdo të dhëne tuaj personale që mund të mblidhet aksidentalisht për qëllimet e Norton Community Watch. Këto të dhëna janë të nevojshme për të identifikuar në mënyrë efektive rreziqet e sigurisë në ose për pajisjen tuaj dhe, nëpërmjet grumbullimit të të dhënave të komunitetit të Norton, për të ofruar informacione thelbësore për lehtësimin e kërcënimeve të tilla të sigurisë dhe për përmirësimin e sigurisë së përdoruesit dhe funksionalitetit të produktit, si dhe për monitorimin e efikasitetit të detyrave specifike të Norton dhe parametrave në pajisjen tuaj. Ju e kuptoni dhe e pranoni se nëse e çaktivizoni mbledhjen e të dhënave për qëllimin e Norton Community Watch duke ndryshuar parametrat e parazgjedhur të pajisjes suaj, ju mund të zvogëloni aftësinë e Symantec për të identifikuar dhe për të lehtësuar me efikasitet rreziqet e sigurisë dhe kjo mund të ketë ndikim në mbrojtjen tuaj dhe të pajisjes suaj nga rreziqe të tilla
- Informacione të telemetrisë për rreziqe të mundshme të sigurisë si dhe adresat URL dhe adresa e protokollit të internetit (IP) të faqeve të vizituara që softueri i konsideron si me mundësi mashtrimi. Ndërkohë që ato adresa IP nuk përbëjnë të dhëna personale në vetvete, URL të caktuara mund të përmbajnë të dhëna personale që një faqe ndoshta mashtruese po përpriqet të marrë pa lejen tuaj. Këto informacione të telemetrisë mblidhen nga Symantec me qëllim ofrimin e funksioneve të softuerit, duke përfshirë mbrojtjen tuaj nga një mbledhje e tillë e paautorizuar e të dhënave tuaja personale si dhe për të vlerësuar dhe për të përmirësuar aftësinë e produkteve të Symantec për të diktuar sjelljet keqdashëse, faqet ndoshta mashtruese dhe rreziqe të tjera sigurie në internet.
- Nëse janë aktivizuar veçoritë Norton Safe Web ose Norton Safe Search, URL-të dhe adresat e protokollit të internetit (IP) për faqet e vizituara si dhe fjalët kyçe të kërkimit dhe rezultatet e kërkimit. Këto informacione të telemetrisë mblidhen nga Symantec me qëllim ofrimin e mbrojtjes që mund të prisni në mënyrë të arsyeshme nga ato funksione si dhe vlerësimin dhe këshillimin tuaj në lidhje me kërcënime dhe rreziqe të mundshme në lidhje me një faqe të caktuar përpara se ta shikoni.
- Skedarë të ekzekutueshëm dhe skedarë që kanë përmbajtje të ekzekutueshme (p.sh. dokumente që përfshijnë makro) që identifikohen si programe të mundshme keqdashëse, duke përfshirë informacionin për veprimet e kryera nga këta skedarë në çastin e instalimit. Këta skedarë i dorëzohen Symantec me anë të funksionit të dorëzimit të softuerit. Ky funksion dorëzimi mund të çaktivizohet pas instalimit duke ndjekur udhëzimet në dokumentacionin kryesor për produktet përkatëse. Skedarët e grumbulluar mund të përmbajnë të dhëna personale, në veçanti informacione në lidhje me ju që janë përfutur nga programi keqdashës pa lejen tuaj. Skedarët e këtij lloji mblidhen nga Symantec vetëm me qëllim përmirësimin e aftësisë së produkteve të Symantec për të zbuluar llojet e sjelljeve keqdashëse të kryera nga softuerë të tillë keqdashës dhe për t'ju ofruar juve dhe përdoruesve të tjerë një mbrojtje superiore ndaj kërcënimeve të ngjashme në të ardhmen.
- Emri që i është dhënë pajisjes gjatë konfigurimit fillestar të pajisjes në fjalë. Nëse grumbullohet, emri përdoret nga Symantec si emër llogarie për pajisjen me të cilin mund të zgjidhni marrjen e shërbimeve të

mëtejshme dhe/ose me të cilin mund të përdorni funksione të caktuara të softuerit. Ju mund ta ndryshoni këtë emër llogarie në çdo kohë pas instalimit të softuerit dhe rekomandohet që ta bëni diçka të tillë.

- Informacioni i ecurisë në lidhje me instalimin dhe përdorimin e softuerit. Ky informacion i tregon Symantec nëse instalimi i softuerit u krye me sukses, si dhe nëse softueri ka hasur ndonjë gabim. Informacioni i ecurisë mund të përmbajë të dhëna personale vetëm nëse këto informacione përmbahen në emrin e skedarit apo të dosjes së hasur nga softueri gjatë çastit të instalimit apo gjatë ndonjë gabimi. Informacioni i ecurisë grumbullohet nga Symantec për qëllime vlerësimi dhe përmirësimi të performancës së produktit nga Symantec si dhe të përqindjes së suksesit të instalimit.
- Informacioni i përmbajtur në mesazhet e emailit që dërgoni nëpërmjet softuerit drejt Symantec për t'i raportuar si të padëshiruara ose si të shënuara gabimisht si të padëshiruara. Të dhënat meta dhe përmbajtjet e mesazheve të tilla të emailit mund të përmbajnë të dhëna personale si adresën e emailit të marrësit, dhe do të dërgohen te Symantec vetëm me lejen tuaj dhe nuk do të dërgohen asnjëherë automatikisht. Nëse ia dërgoni këto mesazhe Symantec, Symantec do t'i përdorë vetëm për qëllime përmirësimi të rendimentit diktues të teknologjisë antireklamë të Symantec. Symantec nuk do t'i kombinojë apo përkohë këta skedarë me të dhëna të tjera personale.
- Informacionet e telemetrisë të përfshira në një raport që mund ta zgjidhni për dërgim nëpërmjet softuerit drejt Symantec kur softueri has një problem. Raporti përmban informacione në lidhje me ecurinë e softuerit dhe të pajisjes në çastin kur softueri hasi problemin. Informacioni i ecurisë rreth pajisjes mund të përfshijë gjuhën e sistemit, kodin e shtetit dhe versionin e sistemit operativ të pajisjes suaj, si dhe proceset e hapura, ecurinë e tyre dhe të dhënat e performancës, dhe të dhënat nga skedarët ose dosjet që ishin hapur në çastin që softueri hasi problemin. Informacioni mund të përmbajë të dhëna personale nëse këto përfshihen, apo nëse janë pjesë e emrit të skedarëve ose dosjeve të hapura në çastin që softueri hasi problemin. Ky informacion do t'i dërgohet Symantec vetëm me lejen tuaj, dhe nuk do të dërgohet asnjëherë automatikisht. Informacioni grumbullohet nga Symantec për qëllim korrigjimi të problemit të hasur dhe për përmirësimin e performancës së produktit të Symantec. Informacioni nuk do të kombinohet apo përkohet me asnjë të dhënë personale.
- Adresa e protokollit të internetit (IP) dhe informacioni përkatës gjeografik dhe/ose adresa e kontrollit të hyrjes së medias (MAC) dhe ID-ja e makinës për pajisjen ku ekzekutohet softueri. Këto informacione mbledhen dhe përpunohen vetëm me qëllim që të bëhet e mundur që softueri të funksionojë si duhet dhe në përputhje me kërkesat e vlefshme lokale, si dhe për qëllime të ligjshme të administrimit të licencave të Symantec.
- Në një pajisje celulare: informacione në lidhje me vendndodhjen e pajisjes suaj nëse aktivizohet funksionaliteti kundër vjedhjes. Imazhet e regjistruar nga kamera e pajisjes nëse ajo është e disponueshme dhe e aktivizuar. Identifikuesi unik universal (UUID) i krijuar si një identifikues i pajisjes suaj për të aktivizuar funksionimin e softuerit dhe të shërbimeve, si dhe për qëllime të administrimit të licencave.
- Në një pajisje celulare: identiteti ndërkombëtar i pajisjes celulare (IMEI) përpunohet për të krijuar një kod hash që siguron anonimitetin. Kodi hash përdoret për të analizuar dhe për të përmbledhur të dhënat e pajisjes për qëllime statistikore. Kodi IMEI nuk mbledhet apo ruhet nga Symantec. Softueri monitoron po ashtu ndryshimet në identitetin ndërkombëtar të abonentit celular (IMSI), për të arritur të vazhdojë ofrimin e shërbimit edhe kur përdoruesit ndërrojnë kartën SIM. Kodi IMSI nuk mbledhet apo ruhet nga Symantec. Informacionet e mësipërme përdoren për qëllimin e identifikimit të pajisjes së telekomunikacionit të përshtatshme për të marrë përditësime të përmbajtjes për softuerin dhe shërbimet. Këto informacione nuk do të lidhen me asnjë informacion tjetër të identifikueshëm personalisht, si p.sh. informacionet e llogarisë suaj. Pas ndërprerjes së shërbimit, të dhënat ruhen në formë statistikore ekskluzivisht për kërkime të brendshme. Symantec mund t'i ndajë këto të dhëna me kontraktorë të palëve të treta dhe/ose përpunues të të dhënave të palëve të treta siç nevojitet për qëllimin e menaxhimit të llogarisë.
- Në një pajisje celulare: adresa e kontrollit të hyrjes së medias me WiFi (MAC) të pajisjes ku është instaluar softueri për të mundësuar funksionimin e softuerit si dhe për qëllimin e administrimit të licencës.

- Informacione të tjera të përgjithshme statistikore për funksionimin e softuerit. Informacione të tilla të përgjithshme dhe statistikore nuk ju identifikojnë dhe as nuk përdoren nga Symantec për t'ju identifikuar ju dhe do të përpunohen në formë të përmbledhur për qëllime të analizave të produktit dhe të përmirësimit të funksioneve të produktit.

Në varësi të parametrave dhe preferencave të konfigurimit tuaj sipas rastit, informacionet e përshkruara më sipër mbledhen në masën e nevojshme dhe në raport të drejtë me qëllimet e dorëzimit, mirëmbajtjes, monitorimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të funksionalitetit të softuerit që mbulohet nga kjo marrëveshje.

Informacioni mund t'i transferohet grupit Symantec në SHBA ose shteteve të tjera që mund të kenë ligje me nivel më të ulët mbrojtjeje për të dhënat sesa në rajonin ku ndodheni (duke përfshirë Bashkimin Evropian) dhe mund të hapen nga punonjësit ose kontraktuesit e Symantec për përdorim ekskluzivisht në përputhje me qëllimet e përshkruara më lart. Për të njëjtat qëllime informacioni mund të ndahet me partnerë dhe shitës që përpunojnë informacione për llogari të Symantec. Symantec ka ndërmarrë hapat e nevojshëm ligjorë, teknikë dhe organizativë për të siguruar që informacionet e mbledhura, nëse transferohen në nivel ndërkombëtar dhe/ose drejt palëve të treta, do të kenë një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje gjatë të gjithë kohës.

Sipas ligjeve në fuqi, Symantec ruan të drejtën të bashkëpunojë me çdo proces ligjor dhe çdo kërkesë qeverie ose të organeve të zbatimit të ligjit që lidhet me përdorimin e softuerit nga ana juaj. Kjo do të thotë se Symantec mund të paraqesë dokumente dhe informacione të kërkuara nga një autoritet i ligjshëm sipas një procesi ligjor të përshtatshëm. Për të nxitur ndërgjegjësimin, diktimin dhe parandalimin e rreziqeve të sigurisë në internet, Symantec mund të ndajë informacione të caktuara me organizata kërkimore dhe shitës të tjerë të softuerëve të sigurisë. Symantec gjithashtu mund të përdorë statistika të prejardhura nga informacioni, për gjurmimin dhe publikimin e raporteve për prirjet e rreziqeve të sigurisë.

Duke përdorur këtë softuer, ju pranoni se Symantec mund të mbledhë, të transmetojë, të ruajë, të zbulojë dhe të analizojë informacionet e përmendura në këtë marrëveshje për këto qëllime të përshkruara në Deklaratën globale të privatësisë së Symantec dhe në produktin dhe shërbimin e Norton që ofrohen në <https://www.symantec.com/privacy>.

9. Kërkesat e Apple. Nëse softueri shkarkohet nga Apple iTunes App Store ("App Store"), ju pranoni dhe konfirmoni kushtet shtesë si më poshtë: (a) Kjo marrëveshje licencimi është vetëm midis ju dhe Symantec dhe jo me Apple, Inc. ("Apple") dhe Apple nuk ka asnjë detyrim për aplikacionin dhe përmbajtjen e tij; (b) përdorimi i softuerit nga ana juaj është i kufizuar me përdorimin e një produkti të markës Apple ku ekzekutohet sistemi operativ iOS që zotëroni ose kontrolloni dhe siç lejohet nga rregullat e përdorimit të përcaktuara në kushtet e shërbimit të App Store; (c) Apple nuk ka asnjë detyrim për të furnizuar për asnjë shërbim mirëmbajtje ose mbështetje në lidhje me softuerin; (d) në rast të ndonjë dështimi të softuerit, për të respektuar ndonjë garanci të zbatueshme që nuk është refuzuar, (i) ju mund të njoftoni Apple, dhe Apple do të rimbursojë çmimin e blerjes që keni paguar nëpërmjet App Store për softuerin dhe (ii) në masën maksimale të lejuar nga ligji në fuqi, Apple nuk do të ketë asnjë detyrim për garancinë në lidhje me softuerin; (e) Apple nuk është përgjegjës për asnjë pretendim, humbje, detyrim, dëmtim, kosto ose shpenzim në lidhje me softuerin ose pronësinë dhe/ose përdorimin e softuerit, duke përfshirë, por pa u kufizuar me (i) detyrimin për produktin ose pretendimet për garancinë; (ii) çfarëdo pretendimi se softueri nuk arrin të respektojë ndonjë kërkesë të vlefshme ligjore ose rregullatore dhe (iii) pretendime për mbrojtjen e konsumatorit ose pretendime të ngjashme; (f) Apple nuk është përgjegjës për hetimin, mbrojtjen, zgjidhjen ose anulimin e çfarëdo pretendimi të palëve të treta se softueri ose pronësia dhe përdorimi i softuerit shkel të drejta të pronësisë intelektuale të një pale të tillë të tretë; (g) ju deklaroni dhe garantoni se (i) ju nuk ndodheni në një shtet që është objekt i embargos së qeverisë së Shteteve të Bashkuara ose që është përcaktuar nga qeveria e Shteteve të Bashkuara si një shtet "që mbështet terroristët" dhe (ii) nuk jeni listuar në asnjë listë të qeverisë së Shteteve të Bashkuara për palët e ndaluara ose të kufizuara; (h) ju jeni përgjegjës për respektimin e çfarëdo kushti të zbatueshëm të marrëveshjes të palëve të treta kur përdorni aplikacionin; dhe (i) Apple dhe degët e tij janë përfitues si palë të treta të kësaj marrëveshjeje licence; si një përfitues si palë e tretë,

Apple do të ketë të drejtën ta zbatojë me detyrim këtë marrëveshje licencimi ndaj jush.

**SHTOJCË PËR
SHËRBIMET NË
MARRËVESHJEN E
LICENCIMIT TË NORTON**

**KUSHTET E
PËRGJITHSHME PËR
SHËRBIMET SHITESË**

**1. REZERVIMI NË LINJË; MBËSHTETJA
TEKNIKE; RINOVIMI AUTOMATIK;
GARANCIA PËR KTHIMIN E PARAVE**

E RËNDËSISHME: LEXONI ME KUJDES KUSHTET E KËSAJ MARRËVESHJEJE SHËRBIMESH ("MARRËVESHJA E SHËRBIMEVE") PËRPARA SE TË PËRDORNI SHËRBIMET (SIÇ PËRCAKTOHEN MË POSHTË). SYMANTEC CORPORATION DHE/OSE FILIALET E SAJ ("SYMANTEC") ËSHTË E GATSHME T'JU OFROJË SHËRBIMET NË CILËSINË TUAJ SI INDIVID, KOMPANI OSE SUBJEKT JURIDIK QË DO TË SHFRYTËZONI SHËRBIMET (PËRMENDUR MË POSHTË SI "JU", "JUAJ", "TUAJ") ME KUSHTIN E VETËM QË TË PRANONI TË GJITHA KUSHTET E KËSAJ MARRËVESHJEJE SHËRBIMESH. KJO KONTRATË ËSHTË E LIGJSHME DHE ZBATUESHME MIDIS JUSH DHE SYMANTEC. ME HAPJEN E KËSAJ PAKETE, GRISJEN E IZOLIMIT, KLIKIMIN TE BUTONI "PRANOJ" OSE "PO", APO FORMAVE TË TJERA TË PËRCAKTUARA TË PRANIMIT ME MJETE ELEKTRONIKE, APO PËRNDRYSHJE PËRDORIMIT TË SHËRBIMEVE, JU BINI DAKORD ME KUSHTET E KËSAJ MARRËVESHJEJE SHËRBIMESH. NËSE NUK BINI DAKORD ME KËTO KUSHTE, SHTYPNI BUTONIN "ANULO" OSE "JO", OSE "MBYLL DRITAREN" APO FORMA TË TJERA PËRKATËSE ME TË CILAT TREGOHET REFUZIMI, MOS I PËRDORNI MË TEJ SHËRBIMET DHE KONTAKTONI (i) ME SHITËSIN OSE ME SHËRBIMIN E SYMANTEC PËR KLIENTËT, SIPAS TË DHËNAVE TË KONTAKTIT TË SEKSIONIT 12 TË KËSAJ MARRËVESHJEJE SHËRBIMESH, PËR INFORMACION MBI RIMBURSIMIN E SHUMËS QË KENI PAGUAR PËR SHËRBIMET AKTUALE (TË PËRCAKTUARA MË POSHTË) (DUKE ZBRITUR TRANSPORTIN, MENAXHIMIN DHE ÇDO TAKSË TË VLEFISHME PËRVEÇSE NË SHITET DHE VENDE TË CAKTUARA KU TRANSPORTI, MENAXHIMI DHE TAKSAT JANË TË RIMBURSUESHME) NË ÇDO KOHË GJATË PERIUdhËS PREJ GJASHTËDHJETË (60) DITËSH PAS DATËS SË BLERJES SË ABONIMIT VJETOR OSE BRENDA TRIDHJETË (30) DITËVE PAS DATËS SË BLERJES SË ABONIMIT MUJOR, OSE (ii) ME OFRUESIN (SIÇ PËRCAKTOHET MË POSHTË) PËR INFORMACION SE SI TË MERRNI RIMBURSIM NËSE I KENI MARRË SHËRBIMET NGA OFRUESI JUAJ.

Sipas kësaj marrëveshjeje shërbimesh, Symantec pranon t'ju ofrojë shërbimet e mëposhtme ("Shërbimet") siç përshkruhen në mënyrë më të plotë në këtë marrëveshje shërbimesh:

1. Kufizimet e shërbimit. Shërbimet mund t'i blini vetëm për përdorimin tuaj personal dhe jo për ndonjë qëllim tregtar. Çdo blerje për qëllimin e rishitjes tregtare nuk është e autorizuar. Nuk ju lejohet, as nuk mund të lejoni të tjerë që:

A. të nënlicenconi, të jepni me qira apo hua ndonjë pjesë të shërbimeve;

B. të shprogrmoni, dekompononi, zbërtheni, modifikoni, përktheni, bëni përpjekje për të zbuluar kodin burimor të shërbimeve ose të krijoni punë derivate nga shërbimet;

C. të jepni, ofroni apo vini në dispozicion shërbimet si pjesë administrimi ambientesh, ndarjeje të kohës, ofruesi shërbimi apo rregullimi zyre shërbimi; ose

D. të përdorni shërbimet në mënyra që nuk lejohen sipas kësaj marrëveshjeje shërbimesh ose ligjit.

Shërbimet mund të përmbajnë veçori dhe funksione të palëve të treta ose mund të hapë përmbajtje në faqe interneti të palëve të treta. Veçori, funksione apo përmbajtje të tilla mund t'u nënshtrohen kushteve të shërbimit dhe rregulloreve të privatësisë së palëve të treta në fjalë.

2. Periudha e shërbimeve.

"Periudha e shërbimit" fillon në datën më të hershme (a) të datës së instalimit ose përdorimit të parë të softuerit nga ana juaj në një kompjuter, mjedis virtual, pajisje celulare ose pajisje kompjuterike portative, (këtu "pajisje"), ose (b) në datën që keni pranuar këtë marrëveshje shërbimesh, ose (c) nëse keni blerë softuerin ose shërbimin tuaj nga dyqani në internet i Norton, data kur keni kryer blerjen, ose (d) nëse e keni marrë shërbimin si pjesë oferte për disa produkte, në datën e blerjes së një oferte të tillë për shumë produkte, ose (d) nëse i keni marrë të drejtat për përdorimin e shërbimit siç përshkruhet në këtë marrëveshje shërbimesh nga një ofrues i autorizuar i Symantec (këtu "ofruesi"), në datën e përcaktuar nga ky ofrues. Periudha e shërbimit zgjat për periudhën e përcaktuar në dokumentacionin kryesor ose në dokumentacionin përkatës të transaksionit nga distributori, rishitësi ose ofruesi i autorizuar nga i cili keni marrë shërbimin. Shërbimi mund të çaktivizohet automatikisht dhe të bëhet jofunksional në fund të periudhës së shërbimit, dhe ju nuk do të keni më të drejtën të merrni shërbimin nëse nuk rinovoni periudhën e shërbimit. Abonimet për rinovime të periudhës së shërbimit (i) do të ofrohen në përputhje me rregulloren e mbështetjes teknike të Symantec të publikuar në https://support.norton.com/sp/en/us/home/current/solutions/v74023230_EndUserProfile_en_us ose (ii) do të ofrohen nga ofruesi juaj në përputhje me rregulloret përkatëse të ofruesit, nëse shërbimin e keni marrë nga ofruesi juaj.

3. Përditësimet automatike të përmbajtjes:

A. Ju keni të drejtën të merrni funksione dhe versione të reja të shërbimeve, ashtu si Symantec, sipas gjykimit të vetëm të saj, i vë në dispozicion këto funksione dhe versione gjatë periudhës suaj të shërbimit. Symantec kërkon gjithnjë të përmirësojë përdorimin dhe performancën e produkteve dhe të shërbimeve të veta. Për të përmirësuar shërbimet dhe për t'ju dhënë versionin më aktual të shërbimeve, ju bini dakord që shërbimet mund të modifikohen nga Symantec sipas gjykimit të vetëm të kësaj. Ju pranoni të merrni dhe i lejoni Symantec të dorëzojë përditësime dhe versione të tilla të reja te ju. Për më tej, Symantec i lejonet të modifikojë kushtet që vlejné për përdorimin e shërbimeve nga ana juaj për t'i pasqyruar këto përditësime dhe versione dhe ju bini dakord me këto kushte të përditësuara. Përveçse nëse keni rënë dakord ndryshe me këto ndryshime, kur vijoni me përdorimin e shërbimeve pas hyrjes në fuqi të modifikimeve, ju bini njëherësh dakord t'u nënshtroheni kushteve të rishikuara.

4. Aktivizimi i kërkuar; Llogaria në Norton:

A. Mund të ketë masa teknologjike në shërbime që janë krijuar për të parandaluar përdorimin e palicencuar ose të paligjshëm të shërbimeve. Ju bini dakord që Symantec mund t'i përdorë këtë masa për t'u mbrojtur nga pirateria ndaj shërbimeve. Kjo marrëveshje shërbimesh dhe shërbimet që përmbajnë teknologjinë detyruese mund të kenë nevojë për aktivizim siç përcaktohet më tej në dokumentacion. Në rast të tillë, shërbimet do të funksionojnë për një periudhë të caktuar përpara aktivizimit të shërbimeve prej jush. Nëse nuk e kryeni aktivizimin brenda kohës së caktuar në dokumentacion, apo siç ju kërkohet nga shërbimet, shërbimet mund të ndalojnë së funksionuari derisa të përfundojë aktivizimi; kohë në të cilën funksionimi i shërbimeve do të rikthehet. Në rast se nuk keni mundësi t'i aktivizoni shërbimet nëpërmjet internetit ose ndonjë forme tjetër të përcaktuar gjatë procesit të aktivizimit, mund të kontaktoni ose (i) mbështetjen e Symantec për klientët, me informacionin që ju jepet nga Symantec, ose siç përcaktohet në seksionin 12 më poshtë, ose (ii) ofruesin tuaj, ose subjektin e përcaktuar në dokumentacionin që ju është lëshuar nga ofruesi juaj, nëse e keni marrë softuerin nga ofruesi juaj.

B. Llogaria në Norton. Mund të nevojitet një llogari aktuale në Symantec Norton (këtu "llogaria në Norton") për të hapur dhe përdorur shërbimet. Në rast të tillë, nëse nuk keni llogari në Norton, duhet të kryeni procesin përkatës të regjistrimit për të krijuar një llogari në Norton për të përdorur shërbimet. Llogaria në Norton mund të mos nevojitet nëse i keni përfitur të drejtat e përdorimit të shërbimeve nga një ofrues që kërkon të keni llogari tjetër përdoruesi (këtu "llogari ofruesi") për të hapur dhe përdorur shërbimet. Shikoni dokumentacionin përkatës të transaksionit me ofruesin tuaj për të përcaktuar nëse nevojitet llogari në Norton apo llogari ofruesi për të hapur dhe përdorur shërbimet. Ju mbani përgjegjësinë e plotë për mirëmbajtjen dhe konfidencialitetin e fjalëkalimit tuaj të llogarisë në Norton ose të llogarisë të ofruesit. Përveç kësaj, nëse i transferoni të gjitha të drejtat tuaja për shërbimet sipas kësaj marrëveshjeje, duhet të hiqni dorë po ashtu nga hyrja ose menaxhimi juaj i çelësit të

licencës për shërbimet e transferuara nga llogaria juaj në Norton. Kontaktoni me shërbimin e klientit të Symantec ose vizitoni faqen e mbështetjes teknike të Symantec të përcaktuar më poshtë.

5. Funksionet e kërkimit të filtruar dhe të rezervimit në internet:

Kërkimi i filtruar. Shërbimet mund të përmbajnë një funksion kërkimi të filtruar që ju bën të mundur të kërkoni në formë të sigurt në internet. Kjo mund të ofrohet, pa u kufizuar vetëm në të, nëpërmjet një shiriti veglash kërkimi ose një shtese shfletuesi nga Symantec.

Rezervimi në internet.

Softueri mund të përmbajë një funksion rezervimi në internet, i cili ofron mundësinë e ruajtjes dhe të gjetjes së të dhënave tuaja në sistemin e Symantec nëpërmjet internetit gjatë periudhës së shërbimit (këtu "funksioni i rezervimit në internet"), sipas nivelit të hapësirës së rezervimit që ju ofrohet nga softueri dhe/ose që blini si shtesë. Nëse zgjidhni të përdorni funksionin e rezervimit në internet, duhet të kryeni procesin e aktivizimit brenda softuerit për këtë funksion.

a. Vënia në dispozicion. Funksioni i rezervimit në internet ofrohet "siç është" dhe "siç vihet në dispozicion" dhe Symantec nuk mban përgjegjësi t'ju paguajë për ndonjë humbje apo dëmtim që mund të shkaktohet nga ndonjë ndërprerje pune e funksionit të rezervimit në internet për shkak mirëmbajtjeje të planifikuar, mirëmbajtjeje për arsye kritike apo forcash përtej kontrollit të arsyeshëm të Symantec.

b. Sjellja dhe përgjegjësia e përdoruesit; pajtimi me ligjet në fuqi. Përdorimi i funksionit të rezervimit në internet (duke përfshirë transmetimin e ndonjë të dhëne që zgjedh të ruash nëpërmjet funksionit të rezervimit në internet (këtu "të dhënat")) u nënshtrohet të gjitha ligjeve dhe rregulloreve përkatëse vendore, shtetërore, kombëtare dhe ndërkombëtare, duke përfshirë, pa u kufizuar vetëm në to, ligjet e SHBA-së për eksportimin. Ju bini dakord të pajtoheni me këto ligje dhe rregullore përkatëse dhe me përcaktimet e dokumentacionit kryesor ose të dokumentacionit përkatës të transaksionit nga distributori, rishitësi apo ofruesi i autorizuar nga i cili keni marrë shërbimet dhe të mos (i) e përdorni funksionin e rezervimit në internet për qëllime të paligjshme, (ii) transmetoni apo ruani materiale që mund të shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale apo të drejta të tjera të palëve të treta apo që janë të paligjshme, dëmtuese, përgojuese, shpifëse apo shkelëse të privatësisë së tjetrit; (iii) transmetoni apo ruani të dhëna që i përkasin një pale tjetër pa marrë më parë pranimet e kërkuara me ligj nga zotëruesi i të dhënave për transmetimin e të dhënave drejt Symantec për ruajtje brenda SHBA-së; (iv) transmetoni materiale që përmbajnë viruse softuerike ose kod, skedarë apo programe të tjera të dëmshme kompjuterike, si p.sh. trojanë, karrema apo bomba kohore; (v) ndërhyini apo ndërpritni punën e serverëve apo të rrjeteve të lidhura me funksionin e rezervimit në internet; ose (vi) përpiqeni të fitoni hyrje të paautorizuar në funksionin e rezervimit në internet, apo në sistemet apo rrjetet kompjuterike të lidhura me funksionin e rezervimit në internet.

Detyrimet tuaja në këtë seksion në lidhje me përdorimin e funksionit të rezervimit në internet vlejné për të gjitha përdorimet e funksionit të rezervimit në internet në lidhje me llogarinë tuaj në Norton. Ju jeni përgjegjës i vetëm për përdorimin e funksionit të rezervimit në internet, dhe për të dhënat e transmetuara apo të ruajtura nëpërmjet funksionit të rezervimit në internet, në lidhje me llogarinë tuaj në Norton.

Deri në maksimumin e lejuar nga legjisllacioni në fuqi, ju bini dakord t'i paguani Symantec, kompanive të saj mëmë, filialeve, degëve, funksionarëve, drejtuesve, punonjësve dhe agjentëve të saj shumën e çdo pretendimi, kërkese, kostoje, dëmi, humbjeje, detyrimi dhe shpenzimi, duke përfshirë tarifat e arsyeshme të avokatëve, të kryera nga cilado palë e tretë që buron për shkak të përdorimit apo në lidhje me përdorimin e funksionit të rezervimit në internet nëpërmjet llogarisë tuaj në Norton deri në masën që këto pretendime, kërkesa, kosto, dëme, humbje, detyrime dhe shpenzime burojnë si rezultat i shkeljes së kësaj marrëveshjeje licencimi nga ana juaj apo i neglizhencës apo abuzimit të qëllimshëm nga ana juaj. Kjo shumë mund të përfshijë, pa u kufizuar vetëm në të, përgjegjësinë për pagesat e këtyre pretendimeve, kërkesave, kostove, dëmeve, humbjeve, detyrimeve dhe shpenzimeve që burojnë si shkak apo në lidhje me të dhënat e transmetuara apo të ruajtura nëpërmjet funksionit të rezervimit në internet në lidhje me llogarinë tuaj në Norton.

c. Përfundimi; Pezullimi. E drejta juaj për të përdorur funksionin e rezervimit në internet do të përfundojë me skadimin e periudhës së shërbimit. Symantec mund të pezullojë apo përfundojë menjëherë përdorimin e funksionit të rezervimit në internet gjatë periudhës së shërbimit për shkak mospajtimi nga ana juaj, ose për shkak opinionit të arsyeshëm të Symantec se keni shkelur kushtet (përtej shkeljeve të papërfillshme apo që nuk kanë pasoja) apo çfarëdo keqpërdorimi të funksionit të rezervimit në internet. Në vijim të skadimit ose të përfundimit të periudhës së shërbimit:

Syantec mund të fshijë përgjithmonë të dhënat e ruajtura në hapësirën e rezervimit në internet që vjen me softuerin dhe shërbimet tuaja;

Syantec nuk ka detyrim t'i mirëmbajë këto të dhëna, t'i përcjellë këto të dhëna te ju apo te ndonjë palë e tretë, apo t'i transferojë këto të dhëna në ndonjë shërbim apo llogari tjetër rezervimi; dhe

Ju nuk do të keni mundësi t'i ruani të dhënat në hapësira të tjera rezervimi që mund t'i keni blerë veçmas përveçse kur rinovohet periudha e shërbimit dhe derisa të rinovohet ajo.

d. Të tjera. Symantec nuk ka asnjë detyrim të monitorojë përdorimin e funksionit të rezervimit në internet dhe/ose të dhënat e transmetuara apo të ruajtura nëpërmjet funksionit të rezervimit në internet. Deri në maksimumin e lejuar nga legjislacioni në fuqi dhe pa marrë parasysh dispozitat e seksionit 10 më poshtë, Symantec ruan të drejtën që në çdo kohë të monitorojë, shqyrtojë, konfiskojë dhe/ose zbulojë cilatdo të dhëna apo informacione të tjera sipas nevojës për t'u pajtuar me ligjet në fuqi, rregulloret, proceset gjyqësore apo kërkesat qeveritare apo për të hetuar përdorimin apo shkelje të dyshuara të kësaj marrëveshjeje licencimi.

6. Mbështetja teknike:

Funksione të caktuara teknike që mund të ofrohen nga brenda softuerit, të cilat mund të përfshijnë bisedën e drejtpërdrejtë me agjentin e mbështetjes teknike dhe/ose asistencën nga agjenti i mbështetjes teknike nëpërmjet hyrjes në kompjuter nga distanca (mbështetja e tillë teknike që ofrohet nga brenda softuerit përmendet në këtë marrëveshje shërbimesh si "mbështetje teknike"). Nëse ofrohen funksione të tilla dhe zgjidhni të përfitonit këtë mbështetje teknike vlejné kushtet e mëposhtme. Çdo mbështetje e tillë teknike ofrohet sipas gjykimit të vetëm të Symantec pa ndonjë garanci të asnjë lloji veç atyre të parashikuara nga legjislacioni për konsumatorin në juridiksionin tuaj, të cilat nuk mund të përjashtohen apo kufizohen në ndonjë mënyrë. Është përgjegjësia juaj e vetme të kryeni një rezervim të të gjitha të dhënave, softuerëve dhe programeve tuaja ekzistuese përpara se të merrni mbështetje teknike. Gjatë kryerjes së mbështetjes teknike, Symantec mund të përcaktojë se problemi teknik është përtej mbulimit të mbështetjes teknike. Symantec ruan të drejtën të refuzojë, pezullojë apo përfundojë cilëndo mbështetje teknike sipas gjykimit të saj të vetëm.

7. Shërbimi i rinovimit automatik të Norton:

Blerja e abonimit në Norton përfshin shërbimin e rinovimit automatik. Në fund të periudhës së shërbimit, shërbimi do të rinovohet automatikisht dhe mënyra juaj e pagesës do të faturohet automatikisht sipas çmimit ekzistues të rinovimit (plus tatimet përkatëse), pa qenë nevoja për veprime të tjera nga ana juaj. Në çdo kohë pas blerjes, mund të ndryshoni cilësimet e abonimit, duke përfshirë anulimin e rinovimit automatik, te "manage.norton.com". Tarifimet e shërbimit të rinovimit automatik vjetor kualifikohen për rimbursim brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga data e blerjes së rinovimit. Shihni Rregulloren e kthimit të Norton për më shumë informacion në lidhje me marrjen e rimbursimeve për produktet e Norton.

8. Shërbimi i rrjetit privat virtual ("VPN")

Shërbimet mund të përfshijnë një veçori të rrjetit VPN ("Shërbimi VPN"). Shërbimi VPN kontrollon nga interneti dhe mund të përfshijë softuerin e klientit të instaluar në pajisjen tuaj që ndërvepron me serverët e Symantec (ose serverë që u përkasin kontraktuesve palë të treta të Symantec) që ju lejojnë të krijoni një lidhje private virtuale. Të gjitha ose disa pjesë të shërbimit të ofruar në këtë kuadër mund të ofrohen nga një ofrues palë e tretë, duke përfshirë, por pa u kufizuar me infrastrukturën e rrjetit. Softueri i klientit në pajisjen tuaj lidhet me një infrastrukturë të rrjetit të serverit që kryhet në internet dhe funksionon si një shërbim i menaxhuar nga Symantec dhe ofrues të tjerë shërbimi. Përdorimi i softuerit të klientit rregullohet nga marrëveshja e licencimit.

A. Përdorimi i pranueshëm.

(i) Ju do të jeni përgjegjës për mirëmbajtjen dhe mbrojtjen e konfidencialitetit të të gjitha informacioneve të llogarisë së Norton

që ju jepet dhe do të jeni plotësisht përgjegjës për të gjitha aktivitetet që ndodhin në llogari të tilla të Norton, (përveçse për aktivitetet e kryera nga Symantec ose të autorizuar shprehimisht nga Symantec).

(ii) Vetëm ju do të jeni përgjegjës për sjelljen tuaj në lidhje me shërbimin. Ju pranoni në mënyrë specifike se do të respektoni dhe do të bashkëpunoni me Symantec për të zbatuar dhe/ose për të parandaluar shkelje të mundshme të Ligjit të mijëvjeçarit për të drejtat dixhitale dhe çdo legjislacioni tjetër të ngjashëm objekt i të cilat jeni

ju, si p.sh. në Bashkimin Evropian, zbatimet në nivel kombëtar të Direktivës 2001/29/EC

të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit të datës 22 maj 2001 për harmonizimin

e aspekteve të caktuara të të drejtave të autorit dhe të të drejtave përkatëse në shoqërinë e informacionit. Në Mbretërinë e Bashkuar, këto

përfshihen në Ligjin për të drejtën e autorit, dizajnet dhe patentat të vitit 1988.

Ju pranoni më tej se nuk do ta përdorni shërbimin:

- a. në shkelje të ndonjë ligji ose rregulloreje në fuqi apo të promovoni shkeljen e çfarëdo ligji ose rregulloreje në fuqi;
- b. për të ngarkuar, për të postuar ose për të transmetuar në një mënyrë tjetër çdo përmbajtje që është e pahijshme, e turpshme ose pornografike, ose që është e kundërshtueshme në një mënyrë tjetër;
- c. në një mënyrë mashtruese ose çorientuese;
- d. për të ngarkuar, postuar ose transmetuar në një mënyrë tjetër përmbajtje për të cilat nuk keni të drejtën ose që mund të shkelin në një mënyrë tjetër të drejtat e pronësisë intelektuale të çfarëdo pale;
- e. në një mënyrë që dhunon ose shkel privatësinë, pronësinë intelektuale, konfidencialitetin ose të drejtat kontraktuale ose të tjera;
- f. në një mënyrë që shkel ose dhunon çdo përdorim të pranueshëm ose politikë ose kusht tjetër që mund të zbatohet për përdorimin tuaj të çfarëdo sistemi kompjuterik, rrjeti ose faqeje interneti;
- g. për të diskredituar, abuzuar, ngacmuar, përndjekur, kërcënuar ose shkelur të drejtat e ligjshme të të tjerëve ose për të kryer veprime që shkaktojnë ndërhyrje në të drejtat e privatësisë së të tjerëve;
- h. për të ngarkuar, postuar ose transmetuar në një mënyrë tjetër përmbajtje që përmbajnë viruse ose kode ose skedarë të tjerë kompjuterikë të dëmshëm si p.sh. kuaj trojanë, krimba, bomba me sahat ose të ngjashme;
- i. për të ngarkuar, postuar ose për të transmetuar në një mënyrë tjetër çdo reklamim të pakërkuar ose të paautorizuar, "emiale të padëshiruara," "të bezdisshme", "letra zinxhir", "skema piramidale" ose çfarëdo forme tjetër kërkese;
- j. për t'u përpjekur të fitoni hyrje të paautorizuar te shërbimi, llogaritë e përdoruesve të tjerë të shërbimit ose sistemet dhe rrjetet kompjuterike të lidhura me shërbimin; ose të ndërhyni në një mënyrë tjetër ose të ndërpritni shërbimin ose serverët ose rrjetet e lidhura me shërbimin;
- k. për të fshirë të drejtat e autorit ose të drejta të tjera të pronësisë për softuerin ose shërbimin;
- l. për ta përdorur shërbimin ose softuerin për përdorim tregtar, duke kuptuar se softueri dhe shërbimi është vetëm për përdorim personal dhe jo tregtar;

- m. për të hequr, shmangur, çaktivizuar, dëmtuar ose ndërhyrë në një mënyrë tjetër në veçoritë e softuerit ose të shërbimit të lidhura me sigurinë, veçoritë që parandalojnë ose kufizojnë përdorimin ose kopjimin e softuerit ose veçoritë që vendosin kufizime mbi përdorimin e shërbimit;
- n. për të shprogramuar, dekompileuar, zbërthyer ose për t'u përpjekur në një mënyrë tjetër për të zbuluar kodin burimor të shërbimit ose të softuerit ose të ndonjë pjese të tyre, përveçse dhe vetëm në masën që një aktivitet i tillë është i lejuar shprehimisht nga ligji në fuqi pavarësisht nga ky kufizim;
- o. për të modifikuar, përshtatur, përkthyer ose krijuar punë rrjedhimore bazuar në softuerin ose shërbimin ose çdo pjesë të tyre, përveçse dhe vetëm në masën që kufizimi i mësipërm është i ndaluar shprehimisht nga ligji në fuqi; ose

Ju e kuptoni se pavarësisht nga përpjekjet e Symantec dhe kushtet e përfshira në këtë marrëveshje shërbimesh, ju mund të ekspozoheni ndaj përmbajtjeve që mund t'i konsideroni fyese, të pahijshme ose të kundërshtueshme gjatë përdorimit të shërbimit VPN dhe, përkatësisht, është përgjegjësia juaj për rrezikun për ekspozimin ndaj përmbajtjeve të tilla.

(iii). Ndryshimet në shërbimin VPN; Ndryshimet në kushtet e shërbimit VPN. Ju keni të drejtën të merrni funksione të reja të shërbimit VPN kur Symantec, sipas gjykimit të vetëm të saj, i vë në dispozicion këto funksione gjatë periudhës suaj të shërbimit. Symantec kërkon gjithnjë të përmirësojë përdorimin dhe performancën e shërbimeve të veta. Për të optimizuar shërbimin VPN, Symantec, sipas gjykimit të vetëm të saj, mund: (i) të shtojë, të modifikojë ose të heqë funksione të shërbimeve VPN, ose (ii) të kufizojë përkohësisht përdorimin e shërbimeve VPN ose të kufizojë disponueshmërinë e tyre për të kryer aktivitetet e mirëmbajtjes, në çdo kohë me ose pa njoftim paraprak për ju. Symantec mund të përditësojë po ashtu kushtet e kësaj marrëveshjeje shërbimesh dhe rekomandon që të kontrolloni kushtet e kësaj marrëveshjeje shërbimesh në mënyrë të rregullt për të parë nëse ato janë përditësuar. Vazhdimi i përdorimit nga ana juaj të shërbimit VPN do të konsiderohet si pranim nga ana juaj i kushteve të përditësuar të kësaj marrëveshjeje shërbimesh.

(iv). Përfundimi dhe pezullimi. E drejta juaj për të përdorur shërbimin VPN do të përfundojë me skadimin e periudhës së shërbimit. Përveç kësaj, Symantec", sipas gjykimit të vetëm të saj, mund të përfundojë ose të pezullojë menjëherë përdorimin tuaj të shërbimit VPN në çdo kohë me ose pa njoftim në rast se shkelni ose nëse Symantec beson në mënyrë të arsyeshme se keni shkelur kushtet e kësaj marrëveshjeje shërbimesh ose nëse përdorimin nga ana juaj të shërbimit VPN mund të bëjë që Symantec të ketë detyrimin ligjor ose të ndërpresë përdorimin e shërbimit VPN nga të tjerë (në një rast të tillë nuk do të bëhet asnjë rimbursim).

9. Garancia e rimbursimit:

Nëse jeni i licencuari fillestar i softuerit dhe i shërbimeve dhe nuk jeni plotësisht i kënaqur me të për çfarëdo arsye, mos e përdorni më softuerin dhe shërbimet dhe kontaktoni me (i) rishitësin e autorizuar që jua ka shitur softuerin dhe shërbimet, ose (ii) rishitësin e autorizuar që ju ka shitur pajisjen që përmban të parainstaluar softuerin dhe shërbimet, nëse e keni marrë softuerin dhe shërbimet si paketë me pajisjen, ose (iii) shërbimin e Symantec për klientët, me të dhënat e kontaktit të përcaktuara në seksionin 12 të kësaj marrëveshjeje shërbimesh, për informacion se si të merrni një rimbursim të shumës që keni paguar për periudhën aktuale të shërbimit (duke zbritur transportin, administrimin dhe çdo taksë të vlefshme, përveçse në shtete dhe vende të caktuara ku transporti, administrimi dhe taksat janë të rimbursueshme) në çdo kohë gjatë periudhës prej gjashtëdhjetë (60) ditësh pas datës së blerjes së një abonimi vjetor, brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data e blerjes së rinovimit automatik të një abonimi vjetor, ose brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e blerjes së një abonimi mujor ("rimbursimi").

Për të evituar dyshimet, rimbursimi nuk vlen nëse softuerin dhe shërbimet i keni marrë nga ofruesi juaj. Për më tej, rimbursimi nuk vlen për riblerje të të njëjtit produkt të Norton që keni blerë dhe për të cilin jeni rimbursuar më parë.

10. Privatësia; Mbrojtja e të

dhënave

(a) Kur përdorni shërbimet, do të zbatohet politika e privatësisë së Symantec që është e disponueshme për rishikim nëpërmjet lidhjes "Politika e privatësisë".

(b) Rregulloret për mbledhjen e të dhënave dhe mbrojtjen e të dhënave të shërbimit VPN. Në lidhje me përdorimin tuaj të shërbimit VPN, Symantec mund të mbledhë nga ju dhe të ruajë, të zbulojë, të transferojë dhe të përpunojë në një mënyrë tjetër të dhëna të caktuara. Këto të dhëna mund të përfshijnë, por nuk janë të kufizuara me të dhënat personale për ju, pajisjet tuaja ose sistemet ose përdorimin tuaj të shërbimeve, si p.sh. informacionet e abonentit dhe të dhënat e pajisjes celulare, përdorimin përmbledhës të internetit dhe të dhëna të përkohshme të përdorimit. Mbledhja e këtyre të dhënave është e nevojshme (a) për të aktivizuar, optimizuar dhe ofruar shërbimet ose mirëmbajtjen/mbështetjen për ju (dhe Symantec mund të përfshijë palë të treta që të bëjnë të njëjtën gjë po ashtu); (b) për të kuptuar përdorimin e produktit dhe për të përmirësuar eksperiencat e përdoruesve me produktet dhe shërbimet në përgjithësi; dhe (c) për të ofruar veprimet e faturimit, të rrjetit dhe mbështetjen. Duke i instaluar dhe/ose përdorur shërbimet, ju pranoni që të lejoni që Symantec të mbledhë të dhënat personale siç përshkruhet në këtë seksion.

(c) Kur kërkonti shërbimet e mbështetjes teknike, informacionet e mëposhtme do të mblidhen dhe do të dërgohen nga pajisja juaj te Symantec nëpërmjet lidhjes së internetit:

- Informacionet e dhëna nga ju për përfaqësuesin e shërbimit të Symantec nëpërmjet telefonit ose të futura nga ju në ndërfaqen e internetit të Symantec kur kërkonti shërbimet; dhe
- Tipi dhe versioni i sistemit operativ dhe shfletuesit të internetit të përdorur nga pajisja juaj.

Gjatë sesionit të shërbimeve, nëse instalohet një vegël softueri për mbështetjen, mund të mblidhen informacionet e mëposhtme nga vegla e softuerit për mbështetjen dhe të dërgohen te Symantec nëpërmjet lidhjes së sigurt:

- Numri i skedarëve të skanuar, kërcënimet e gjetura dhe kërcënimet e rregulluara nga vegla e softuerit për mbështetjen;
- Tipi i kërcënimeve të gjetura;
- Numri dhe tipi i kërcënimeve të mbetura që nuk janë rregulluar nga vegla e softuerit për mbështetjen;
- Nëse një mur mbrojtës është aktiv;
- Nëse softueri antivirus është i instaluar, në ekzekutim dhe i përditësuar;
- Informacionet e shfletuesit duke përfshirë parametrat e sigurisë dhe të skedarëve të përkohshëm;
- Informacionet e sistemit në lidhje me sistemin operativ, memorien dhe hapësirën e diskut, konfigurimin e përfaqësuesit dhe listimet e direktorive për veglën e softuerit për mbështetjen;
- Statusi i sigurisë (i mirë/i pranueshëm/i dobët) për pajisjen siç përcaktohet nga vegla e softuerit për mbështetjen;
- Programet e instaluara dhe informacionet për proceset aktive; dhe
- Informacionet për skedarët e evidencave të aplikacioneve dhe të dhënat e regjistrimit.

(d) Për më tej, çdo e dhënë që zgjidhni të transmetoni apo ruani nëpërmjet funksionit të rezervimit në internet (nëse ka) do të transferohet dhe ruhet në serverë që ndodhen në shtete me ligje me nivel më të ulët mbrojtjeje për të dhënat se sa shteti ku ndodhni (duke përfshirë pa kufizime SHBA-në). Këta serverë drejtohen nga një përpunues si palë e tretë të cilit Symantec i ka kërkuar me kontratë përkatëse ligjore të mbrojtë të dhënat tuaja. Nëse keni ndonjë pyetje se si administrohen të dhënat tuaja, kontaktoni me shërbimin e Symantec për klientët me të dhënat e kontaktit në seksionin [12] "Të përgjithshme".

Të gjitha informacionet e mbledhura siç përcaktohet më sipër janë të nevojshme për qëllimin e ofrimit të

shërbimeve, duke përfshirë analizimin, diagnostikimin, zgjidhjen e problemit që keni hasur dhe optimizimin e funksionalitetit të produkteve dhe shërbimeve të Symantec. Informacioni mund t'i transferohet grupit Symantec në SHBA ose shteteve të tjera që mund të kenë ligje me nivel më të ulët mbrojtjeje për të dhënat sesa në rajonin ku ndodheni (duke përfshirë Bashkimin Evropian), por Symantec ka ndërmarrë hapa që informacionet e mbledhura, nëse transferohen, do të kenë një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje.

Symantec mund t'i zbulojë informacionet e mbledhura nëse kjo gjë kërkohet nga një zyrtar i zbatimit të ligjit siç kërkohet ose lejohet nga ligji dhe në përgjigje të një thirrjeje gjyqësore ose një procesi tjetër ligjor. Për të nxitur ndërgjegjësimin, diktimin dhe parandalimin e rreziqeve të sigurisë në internet, Symantec mund të ndajë informacione të caktuara me organizata kërkimore dhe shitës të tjerë të softuerëve të sigurisë. Symantec gjithashtu mund të përdorë statistika të prejardhura nga informacioni, për gjurmimin dhe publikimin e raporteve për prirjet e rreziqeve të sigurisë.

Detajet e plota të politikës së privatësisë së Symantec mund t'i gjeni këtu:

<https://www.symantec.com/privacy>

11. Informacione të tjera të rëndësishme

11.1. Mohimi i përgjegjësisë për garancinë.

Për klientët tregtarë

NË MASËN MAKSIMALE TË LEJUAR NGA LEGJISLACIONI NË FUQI, (i) GARANCIA E MËSIPËRME ËSHTË EKSKLUZIVE DHE ZËVENDËSON TË GJITHA GARANCITË E TJERA, QOFSHIN ATO TË PËRCAKTUARA SHPREHIMISHT APO TË NËNKUPTUARA, DUKE PËRFSHIRË GARANCITË E NËNKUPTUARA PËR CILËSINË DHE PËRSHTATSHMËRINË E KËNAQSHME PËR NJË QËLLIM TË CAKTUAR DHE (ii) SYMANTEC NUK JEP ASNJË GARANCI NË LIDHJE ME MOSSHKELJE TË TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE.

LEGJISLACIONE TË CAKTUARA MUND TË NËNKUPTOJNË GARANCI APO TË IMONOJNË DETYRIME MBI SYMANTEC, TË CILAT (i) NUK MUND TË PËRJASHTOHEN, KUFIZOHEN APO MODIFIKOHEN, OSE (ii) NUK MUND TË PËRJASHTOHEN, KUFIZOHEN APO MODIFIKOHEN PËRVEÇSE DERI NË NJË MASË TË CAKTUAR. KJO MARRËVESHJE DUHET LEXUAR SIPAS KËTYRE DISPOZITAVE LIGJORE. NËSE VLEJNË KËTO DISPOZITA LIGJORE, PA MARRË PARASYSH DISPOZITA TË TJERA NË KËTË MARRËVESHJE DHE DERI NË MASËN QË SYMANTEC KA TË DREJTË TË KRYEJË DIÇKA TË TILLË, SYMANTEC KUFIZON PËRGJEGJËSINË E SAJ NË LIDHJE ME ÇFARËDO PRETENDIMI SIPAS KËTYRE DISPOZITAVE NË (PËR SA U PËRKET SHËRBIMEVE, SIPAS MUNDËSISË SË SYMANTEC): ZËVENDËSIMIN E SHËRBIMEVE OSE OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË BARASVLERSHME; RIPARIMIN E SHËRBIMEVE; PAGESËN E KOSTOS SË ZËVENDËSIMIT TË SHËRBIMEVE OSE TË BLERJES SË SHËRBIMEVE TË BARASVLERSHME; OSE PAGESËN E KOSTOS PËR RIPARIMIN E SHËRBIMEVE NË LIDHJE ME CILINDO SHËRBIM, SIPAS MUNDËSISË SË SYMANTEC, RIOFRIMIN E SHËRBIMEVE OSE PAGESËN E KOSTOS PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE. SHKRUAJINI (I) SYMANTEC CUSTOMER SUPPORT, PO BOX 5689, DUBLIN 15, IRELAND OR (II) SYMANTEC CUSTOMER SERVICE AT LEVEL 3, 437 ST KILDA RD, MELBOURNE, VIC 3004, AUSTRALIA OSE VIZITONI FAQEN E MBËSHTETJES TEKNIKE PËR SHTETIN APO RAJONIN TUAJ, QË MUND TA GJENI TE <https://www.symantec.com/globalsites/> PËR INFORMACION RRETH ZËVENDËSIMIT TË SHËRBIMEVE APO PËR TË MARRË NJË RIMBURSIM TË SHUMËS QË KENI PAGUAR PËR PERIU DHËN AKTUALE TË SHËRBIMIT NË ÇDO KOHË GJATË PERIU DHËS PREJ GJASHTËDHJETË (60) DITËSH PAS DATËS SË BLERJES SË NJË ABONIMI VJETOR, OSE BRENDA TRIDHJETË (30) DITËVE PAS DATËS SË BLERJES SË NJË ABONIMI MUJOR.

Për klientët konsumatorë

Përveç garancisë që ju jep Symantec sipas seksionit 7 të {104}SHTOJCËS SË SHËRBIMEVE PËR MARRËVESHJEN E LICENCIMIT TË NORTON - KUSHTET PËR{105} {106}SHËRBIMET SHTESË{107} {108}{109}dhe të drejtave që gëzoni si konsumator, Symantec nuk ju ofron garanci të mëtejshme në lidhje me

softuerin dhe shërbimet.

Shkruajini (i) Symantec Consumer Support, PO Box 5689, Dublin 15, Ireland ose vizitoni faqen e mbështetjes teknike për shtetin apo rajonin tuaj, që mund ta gjeni te <https://www.symantec.com/globalsites/> për informacion rreth zëvendësimit të mjeteve me defekt apo për të marrë një rimbursim të shumës që keni paguar për periudhën aktuale të shërbimit në çdo kohë gjatë periudhës prej gjashtëdhjetë (60) ditësh pas datës së blerjes së një abonimi vjetor, ose brenda tridhjetë (30) ditëve pas datës së blerjes së një abonimi mujor.

11.2. Kufizimi i detyrimit.

11.2.1 Detyrimi ndaj klientëve tregtarë:

Nëse jeni konsumator, dispozitat e mëposhtme të këtij seksioni 1 nuk vlejnë për ju, përveçse deri në masën që sipas ligjeve në fuqi në juridiksionin tuaj vlejnë dispozita të caktuara për formën tuaj të përdorimit të shërbimeve pavarësisht faktit nëse ky përdorim është për qëllime aktiviteti tregtar, zanati apo profesioni. Në vend të këtij lexoni seksionin 9.2.2.

Nëse jeni klient tregtar (d.m.th. po i përdorni shërbimet në kuadër të një aktiviteti tregtar, zanati apo profesioni (këtu "klient tregtar")), për ju vlejnë dispozitat e mëposhtme të këtij seksioni 9.2.1 (pavarësisht nëse i keni pranuar apo jo shërbimet).

A. NË MASËN MAKSIMALE TË LEJUAR NGA LEGJISLACIONI NË FUQI, NË ASNJË RAST SYMANTEC APO LICENCUESIT E SAJ NUK KANË DETYRIME NDAJ JUSH (NË RAST NEGLIZHENCE, KONTRATE APO ARSYEJE TJETËR) PËR HUMBJE FITIMESH, TË ARDHURASH, KONTRATASH TREGTARE, KURSIMESH TË PARASHIKUARA APO HUMBJE DHE DËMTIM TË TË DHËNAVE QË MUND TË BUROJNË NGA PËRDORIMI APO PAMUNDËSIA PËR TË PËRDORUR SHËRBIMET (DUKE PËRFSHIRË, PA U KUFIZUAR VETËM NË TË, PËRDORIMIN E FUNKSIONIT TË REZERVIMIT NË INTERNET DHE MBËSHTETJEN TEKNIKE) OSE PËR ÇFARËDO DËMESH TË POSAÇME, SHKAKËSORE, TËRTHORE APO TË NGJASHME, EDHE NËSE SYMANTEC ËSHTË NJOFTUAR PËR MUNDËSINË E DËMEVE TË TILLA.

B. NË MAKSIMUMIN E PARASHIKUAR NGA LEGJISLACIONI NË FUQI, DETYRIMI I SYMANTEC APO I LICENCUESVE TË SAJ NUK TEJKALON ÇMIMIN E BLERJES QË KENI PAGUAR PËR PERIUDHËN PËRKATËSE TË SHËRBIMIT.

C. Symantec mban përgjegjësi ndaj jush pa kufizime nëse (a) ju vdisni apo lëndoheni për shkak të neglizhencës nga ana e Symantec ose (b) pësoni humbje apo dëmtim në rast se Symantec vepron në formë mashtruese.

11.2.2 Detyrimi ndaj konsumatorëve:

Nëse jeni konsumator, ky seksion 9.2.2 vlen për ju. Lexojeni me kujdes. Seksioni 9.2.2 nuk vlen për ju nëse jeni klient tregtar. Symantec mban përgjegjësi ndaj jush pa kufizime nëse (a) ju vdisni apo lëndoheni për shkak të neglizhencës nga ana e Symantec ose (b) pësoni humbje apo dëmtim në rast se Symantec vepron në formë mashtruese.

A. Sipas dispozitave të mëparshme të këtij seksioni 9.2.2, Symantec nuk mban përgjegjësi pagese ndaj jush për çfarëdo humbje që nuk është pasojë logjike dhe parashikueshme e një shkeljeje të kësaj marrëveshjeje licencimi nga ana e Symantec. Si konsumator, përdorimi i shërbimeve nga ana juaj do të jetë jotregtar. Symantec kështu nuk mban përgjegjësi ndaj jush për çfarëdo humbje të fitimeve, të ardhurave, kursimeve të parashikuara, kontratave apo kohës që buron nga përdorimi apo pamundësia e përdorimit të softuerit në rast të një defekti kryesor.

B. Ju rekomandojmë së tepërmi që t'i rezervoni shpesh të dhënat tuaja.

C. Në çdo kohë do të keni detyrimin të ndërmerri hapa të arsyeshëm për të minimizuar humbjet.

11.3. Të drejtat e pronësisë. Symantec ruan pronësinë për të gjitha të drejtat e pronësisë për shërbimet, dhe për të gjithë emrat tregtarë, markat tregtare dhe markat e shërbimit të lidhura ose të shfaqura me shërbimet. Ju nuk do të hiqni, dëmtoni ose fshihni asnjë nga njoftimet e të drejtave të autorit ose markave tregtare të Symantec dhe/ose legjendat ose njoftime të tjera të pronësisë, të përfshira aty, ose të lidhura me shërbimet. Nuk mund të shpogramoni, dekompononi ose të zbërtheni në formën e lexueshme nga njeriu asnjë shërbim.

11.4. Forca madhore. Në masën maksimale të lejuar nga ligji në fuqi, Symantec nuk do të jetë përgjegjëse për asnjë dështim në veprime për shkak të rrethanave të paparashikuara ose për shkaqe jashtë kontrollit të arsyeshëm të Symantec, duke përfshirë, por pa u kufizuar me veprat e Zotit, lufta (e deklaruar apo jo), revolta, embargo, veprime të autoriteteve civile ose ushtarake, sulm terrorist ose kërcënim për sulm terrorist, zjarr, përmbajtje, aksidente, greva, ndërprerje pune, dështime të infrastrukturës dhe rrjeteve publike ose private të telekomunikacioneve ose ndërprerje të transportit, shërbimeve, karburantit, energjisë, punës ose materialeve. Në rast të një vonese të tillë, Symantec mund të justifikohet për një performancë të tillë për sa kohë që vonohet ose pengohet nga një shkak i tillë.

11.5. Rregullorja e eksportimit. Ju pranoni se softueri, bashkë me shërbimet dhe të dhënat përkatëse teknike (të gjitha së bashku këtu "teknologji e kontrolluar") mund t'u nënshtrohen ligjeve për import-eksportin të SHBA-së, veçanërisht rregulloreve për administrimin e eksportit të SHBA-së (EAR), dhe ligjeve të cilido shteti ku importohet apo rieksporthet teknologjia e kontrolluar. Ju bini dakord të pajtoheni me të gjitha ligjet përkatëse dhe të mos eksportoni ndonjë teknologji të kontrolluar në shkelje të legjisllacionit të SHBA-së, as të ndonjë shteti, subjekti apo personi të ndaluar për të cilat kërkohet licencë eksporti apo miratim qeveritar në formë tjetër. Të gjitha abonimet e Norton ndalohen të eksportohen apo të rieksporthen në Kubë, Kore të Veriut, Iran, Siri dhe Sudan dhe drejt çdo shteti që është objekt i sanksioneve përkatëse tregtare. Ju pranoni këtu se nuk do të eksportoni apo shitni asnjë teknologji të kontrolluar për përdorim në lidhje me armë kimike, biologjike ose nukleare, ose raketa, drone ose mjete të lëshimit hapësinor të afta për dërgimin e armëve të tilla.

12. Të përgjithshme

A. Ligji rregullator. Kushtet do të rregullohen nga ligjet e Anglisë dhe të Uellsit. Asgjë në këto kushte nuk i pakëson të drejtat që mund të gëzoni sipas legjisllacionit ekzistues për mbrojtjen e konsumatorit apo ligje të tjera në fuqi në juridiksionin tuaj që nuk tërhiqen me kontratë.

B. Marrëveshja e plotë. Kushtet përbëjnë të gjithë marrëveshjen midis jush dhe Symantec në lidhje me shërbimet dhe: (i) tejkalojnë të gjitha komunikimet, propozimet dhe deklaratat e mëparshme apo aktuale verbale apo me shkrim, në lidhje me çështjen në fjalë; dhe (ii) mbizotërojnë ndaj çdo kushti konfliktual apo shtesë për çmime, porosi, pranime apo komunikime të ngjashme midis palëve. Kushtet do të ndërpriten menjëherë në rast të shkeljes së kushteve nga ana juaj, duke përfshirë por jo kufizuar në: shkeljen e përgjegjësive tuaja bazë, duke përfshirë detyrimet për pagesën dhe mostransferimin, sipas Seksionit 1 ose 4 këtu, dhe/ose shkeljen e të drejtave të pronësisë së Symantec, ose ligjeve në fuqi për importimin dhe eksportimin sipas Seksioneve 11.3 ose 11.5 këtu, si dhe do të ndërpritni menjëherë përdorimin e shërbimeve. Mohimet e përgjegjësive për garancitë dhe dëmtimet si dhe kufizimet për detyrimin të përcaktuara te kushtet vazhdojnë të mbeten në fuqi edhe pas përfundimit. Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me kushtet ose nëse dëshironi të kontaktoni me Symantec për çfarëdo arsye, shkruani te Symantec Customer Support, PO Box 5689, Dublin 15, Ireland ose vizitoni faqen e mbështetjes për shtetin ose rajonin tuaj që mund të ndodhet në <https://www.symantec.com/globalsites/>. Symantec nuk do të paraqesë një kopje të kushteve.

CPS / SUBS_SOS 22.15 / IE

2. PREMTIMI I NORTON PËR MBROJTJEN NGA VIRUSET

NËSE KENI ZGJEDHUR OSE KENI NISUR NJË SHËRBIM TË QUAJTUR "PREMTIMI I NORTON PËR MBROJTJEN NGA VIRUSET" ("SHËRBIMET") NËPËRMJET FAQES SË SYMANTEC ("FAQJA"), ZBATOHEN KUSHTET E PËRGJITHSHME SI MË POSHTË ("KUSHTET"). KËTO KUSHTE PËRBËJNË NJË KONTRATË

LIGJORE DHE TË DETYRUESHME MES SYMANTEC CORPORATION DHE FILIALEVE TË SAJ ("SYMANTEC") DHE JUSH PËR PËRDORIMIN E SHËRBIMEVE. SHËRBIMET JU JAPIN HYRJE 24 ORË NË 7 DITË TË JAVËS TEK EKSPERTËT PRAKTIKË TË NORTONLIVE NGA SYMANTEC. "JU" OSE "JUAJ" I REFEROHET INDIVIDIT QË PO PËRDOR SHËRBIMET. POLITIKA DHE MATERIALET E PËRMENDURA NË MËNYRË SPECIFIKE TE KUSHTET JANË TË PËRFSHIRA TE KUSHTET SI REFERENCË. PARA SE TË KLIKONI TE BUTONI "UNË PRANOJ" OSE "PRANOJ" OSE TË TREGONI NË NJË MËNYRË TJETËR PRANIMIN PËR VAZHDIMIN E PËRDORIMIT TË SHËRBIMEVE, LEXONI ME KUJDES KUSHTET MË POSHTË.

NËSE NUK I PRANONI KUSHTET, ATËHERË SYMANTEC NUK ËSHTË E GATSHME T'JU OFROJË SHËRBIMET. NË NJË RAST TË TILLË JU DUHET QË: (A) TË KLIKONI TEK "ANULO" OSE NJË BUTON TJETËR I NGJASHËM, OSE TË TREGONI REFUZIMIN NË NJË MËNYRË TJETËR; DHE (B) TË MOS I PËRDORNI SHËRBIMET DHE TË KONTAKTONI ME SHËRBIMIN E KLIENTIT TË SYMANTEC, DUKE PËRDORUR DETAJET E KONTAKTIT NË MARRËVESHJEN PËRKATËSE TË LICENCËS.

NJOFTIM I RËNDËSISHËM - PERIUDHA E KUFIZUAR E DËMSHPËRBLIMIT DHE TË DREJTAT PËR RIMBURSIMIN:

- NËSE I KENI BLERË SHËRBIMET NËPËRMJET NJË BLERJEJE NË INTERNET NËPËRMJET NORTON.COM, ATËHERË E DREJTA PËR TË PËRDORUR SHËRBIMET DO TË FILLOJË NË DATËN KUR KENI BLERË ABONIMIN TUAJ TË NORTON QË PËRFSHIN SHËRBIMIN DHE DO TË ZGJASË PËR PERIUDHËN E KOHËS TË PËRCAKTUAR NË DOKUMENTACIONIN E ABONIMIT TË BLERË TË NORTON.
- NËSE I KENI MARRË SHËRBIMET NËPËRMJET REGJISTRIMIT TUAJ NË SHËRBIMIN E RINOVIMIT AUTOMATIK TË NORTON, ATËHERË E DREJTA E PËRDORIMIT TË SHËRBIMEVE DO TË FILLOJË NË DATËN E REGJISTRIMIT TUAJ DHE DO TË ZGJASË PËR KOHËZGJATJEN E ABONIMIT AKTUAL TË NORTON NË ATË KOHË OSE DERI SA TA ANULONI REGJISTRIMIN TUAJ NË SHËRBIMIN E RINOVIMIT AUTOMATIK TË NORTON, CILA TË NDODHË MË PARË.

SHËNIM: DISA SHTETE DHE JURIDIKSIONE NUK LEJOJNË KUFIZIMIN E TË DREJTAVE TË RIMBURSIMIT SIÇ PËRSHKRUHET NË KËTË DISPOZITË, KËSHTU QË KJO DISPOZITË MUND TË MOS JETË E VLEFSHME PËR JU. PËRVEÇ KËSAJ, KJO DISPOZITË NUK KA NDIKIM NË ASNJË TË DREJTË TJETËR TË VLEFSHME PËR RIMBURSIMIN. DUKE KLIKUAR TE "PRANOJ" OSE BUTONI "PRANOJ" OSE ME PËRDORIMIN E SHËRBIMEVE NGA ANA JUAJ, JU VLERËSOHENI SE KENI PRANUAR DHE KENI DHËNË PËLQIMIN PËR KËTO KUSHTE DETYRUESE.

Premtimi i Norton për mbrojtjen nga viruset

Premtimi për mbrojtjen nga viruset përfshin një shërbim për heqjen e viruseve të ofruar nga një ekspert i Norton dhe vjen me abonimet e mëposhtme kualifikuese të Norton. Norton Security (Standard, Deluxe ose Premium), Norton Small Business, Norton Internet Security, Norton AntiVirus, Norton 360 dhe Norton 360 Multi-Device. Në një rast pak të mundshëm kur nuk mund ta heqim virusin nga pajisja juaj, mund të gëzoni të drejtën për një rimbursim të abonimit të Norton ose të paketës së Norton (sipas rastit). Për të pasur të drejtën për një rimbursim, zbatohen kushtet e mëposhtme:

- (a) Përveçse nëse jeni një abonent i Norton Small Business, ju duhet të blini, të rinovoni ose të përmirësoni abonimin tuaj të lejuar të Norton drejtpërdrejt nga Norton.com ose të abonoheni te shërbimi i rinovimit automatik të Norton me abonimin tuaj të lejuar të Norton;
- (b) Rimbursimi juaj do të jetë një rimbursim i plotë bazuar në çmimin aktual të paguar për periudhën e abonimit aktual të Norton. Nëse keni blerë një paketë të Norton (të përcaktuar si abonime të Norton dhe/ose shërbime të Norton), rimbursimi juaj do të bazohet në çmimin aktual të paguar për periudhën e paketës tuaj aktuale të Norton. Ose nëse blerja e paketës përmban një abonim të Norton me një abonim/produkt jo të Norton, rimbursimi juaj do të kufizohet në çmimin e shitjes të sugjeruar nga prodhuesi (MSRP) për abonimin tuaj të Norton për periudhën aktuale, pa e kaluar çmimin total të paguar për atë paketë. Rimbursimi do të jetë neto në lidhje me zbritjet ose rimbursimet e marra dhe duke zbritur transportin, administrimin dhe taksat e zbatueshme, përveçse në shtete dhe vende të caktuara ku transporti, administrimi dhe taksat janë të rimbursueshme.
- (c) Nëse e keni blerë abonimin tuaj të Norton nga një rishitës, kërkohet dëshmia e blerjes;

- (d) Symantec nuk është përgjegjëse dhe rimbursimi NUK zbatohet për humbjet ose dëmtimet e shkaktuara si rezultat i viruseve; dhe
- (e) Ligji ose rregulloret në fuqi në shtetin ku do të kryhet shërbimi i heqjes së virusit mund të kufizojnë ose të ndryshojnë disponueshmërinë ose fushën e premtimit për mbrojtjen nga viruset.

1. Shërbimet

1.1. Përmbledhja për shërbimin

(1) Hyrja. Symantec do të ofrojë shërbimet siç përcaktohet te kushtet dhe vetëm mbi bazën që përdorimi i shërbimeve nga ana juaj do të jetë jotregtar. Përfaqësuesi i shërbimit të Symantec do të përpiqet t'ju ofrojë shërbimet nëpërmjet telefonit, nëpërmjet një sesioni bisede të drejtpërdrejtë në pajisjen tuaj ose me email. Për të optimizuar shërbimet dhe vetëm në masën e lejuar nga ligji në fuqi, Symantec, sipas gjykimit të saj të vetëm, mund të modifikojë veçoritë ose përshkrimet e shërbimeve herë pas here; sidoqoftë kjo nuk do të ketë ndikim negativ në cilësinë e ndonjë shërbimi specifik që Symantec ka pranuar shprehimisht që t'ju ofrojë.

(2) Vegla e softuerit për mbështetjen dhe hyrja në largësi. Gjatë një sesioni shërbimi, Symantec mund (i) t'ju kërkojë të instaloni softuerë të caktuar të mbështetjes në pajisjen tuaj duke shkarkuar softuerin e mbështetjes nga faqja dhe/ose (ii) t'ju kërkojë lejen tuaj për të përdorur veglën e ndihmës në largësi nëpërmjet përfaqësuesit të shërbimit të Symantec për të bërë të mundur që Symantec të hyjë dhe të marrë kontrollin e pajisjes suaj në largësi; dhe/ose (iii) të përdorë softuerë të caktuar të mbështetjes të palëve të treta në pajisjen tuaj që do të hiqen pas përfundimit të sesionit të shërbimeve. Softueri i mbështetjes (duke përfshirë çdo softuer të mbështetjes të palëve të treta) dhe vegla e ndihmës në largësi janë në pronësi të Symantec ose licencues dhe furnizues përkatës të palëve të treta dhe mund të përmenden në mënyrë të përmbledhur si "vegla e softuerit për mbështetjen" te kushtet. Vegla e softuerit për mbështetjen do të përdoret për të analizuar, diagnostikuar, zgjidhur probleme më të vështira dhe/ose për të ofruar funksione të optimizimit të sistemit. Mund ta përdorni veglën e softuerit për mbështetjen vetëm si pjesë ose për përdorim me shërbimin dhe për asnjë qëllim tjetër. Duke zgjedhur të merrni mbështetje, ju pranoni që të lejoni Symantec të përdorë çdo vegël softueri të mbështetjes siç vlerësohet e nevojshme për riparimin e pajisjes suaj, duke përfshirë hyrjen në largësi. Ju e kuptoni se nëse përdoret hyrja në largësi në pajisjen tuaj, nuk do të ketë asnjë softuer të mbetur nga sesioni i shërbimeve; sidoqoftë, mund të ketë një raport të krijuar nga xml ose flash. Ju e kuptoni po ashtu se nëse zgjidhni të instaloni veglën e softuerit për mbështetjen në pajisjen tuaj, duke shkarkuar veglën e softuerit për mbështetjen, ju pranoni të përdorni veglën e softuerit për mbështetjen në përputhje me marrëveshjen e përdorimit të veglës së softuerit për mbështetjen të Symantec që ndodhet në http://ftp.symantec.com/public/english_us_canada/premium_services/Support_Tool_EULA.pdf ("Marrëveshja e përdorimit të veglës së softuerit për mbështetjen"). Në një rast të tillë, ju do të ndërpriteni përdorimin e veglës së softuerit për mbështetjen dhe do ta hiqni atë nga pajisja juaj në fund të sesionit të shërbimeve.

Syantec mund të monitorojë dhe të regjistrojë, por nuk ka asnjë detyrim për ta bërë këtë, sesionet e shërbimeve, përfshirë telefonatat dhe sesionet në internet për qëllimin e përmirësimit të shërbimit të klientit, trajnime të brendshme dhe kërkimet të brendshme të tregut. Ju i jepni këtu lejen Symantec që të monitorojë dhe të regjistrojë shërbimet dhe të përdorë ose të zbulojë çdo informacion siç është e nevojshme ose e përshtatshme për të respektuar çdo ligj, rregullore ose kërkesë tjetër qeveritare; për t'ju ofruar shërbimet juve ose përdoruesve të tjerë dhe për të përmirësuar llojet e shërbimeve që Symantec mund t'ju ofrojë juve në të ardhmen. Ju i jepni po ashtu Symantec lejen që të kombinojë informacionet tuaja me informacionet e të tjerëve në një mënyrë që nuk ju identifikon personalisht ju ose një individ për përmirësimin e shërbimeve, për trajnime, për marketing dhe qëllime promovionale, si dhe për qëllime të tjera tregtare.

(3) Përshkrimi i shërbimeve, kërkesat minimale. Disa pajisje mund të mos arrijnë të marrin shërbimet edhe nëse testimi fillestar ka treguar se lidhja juaj është kualifikuar ose nëse mjedisi i pajisjes suaj ka qenë i përshtatshëm. Për të marrë shërbimet kërkohet një lidhje interneti me shpejtësi të lartë. Symantec do t'ju ofrojë shërbimin në rast se ju i plotësoni kërkesat minimale të sistemit si më poshtë:

Windows XP 32 bitë (Paketa e shërbimit 3 ose e mëvonshme) Professional, Home Edition ose Media Center 2005

- 500 MHz CPU

- 512 MB RAM
- 500 MB hapësirë e disponueshme në njësinë e hard diskut
- Super VGA (800 x 600) ose rezolucion më i lartë (përshtatësi i videos)
- Duhet të hyni si administrator

Windows Vista 32 bitë ose 64 bitë (të gjitha paketat e shërbimit) Home Basic, Home Premium, Business ose Ultimate

- 1 GHz CPU
- Kërkohej 512 MB RAM (rekomandohet 1 GB)
- 500 MB (32 bitë) ose 850 MB (64 bitë) hapësirë e disponueshme në njësinë e hard diskut
- Super VGA (800 x 600) ose rezolucion më i lartë (përshtatësi i videos)
- Duhet të hyni si administrator

Windows 7 32 bitë ose 64 bitë (të gjitha paketat e shërbimit) Home Basic, Home Premium, Business ose Ultimate

- 1 GHz CPU
- Kërkohej 512 MB RAM (rekomandohet 1 GB)
- 500 MB (32 bitë) ose 850 MB (64 bitë) hapësirë e disponueshme në njësinë e hard diskut
- Super VGA (800 x 600) ose rezolucion më i lartë (përshtatësi i videos)
- Duhet të hyni si administrator

Windows 8 32 bitë (të gjitha paketat e shërbimit) Home Basic, Home Premium, Business ose Ultimate

- 1 GHz CPU
- Kërkohej 512 MB RAM (rekomandohet 1 GB)
- 500 MB (32 bitë) ose 850 MB (64 bitë) hapësirë e disponueshme në njësinë e hard diskut
- Super VGA (800 x 600) ose rezolucion më i lartë (përshtatësi i videos)
- Duhet të hyni si administrator

Windows 10 (të gjitha paketat e shërbimit) Home ose Pro

- 1 GHz CPU ose më i shpejtë
- 1 GB (32 bitë) ose 2 GB (64 bitë)
- 16 GB (32 bitë) ose 20 GB (64 bitë) hapësirë e disponueshme në njësinë e hard diskut
- Pajisje me grafikë Microsoft DirectX 9 me drejtuesin WDDM 1.0
- Ekranin në përputhje me rezolucionin 800x600
- Duhet të hyni si administrator

Kërkesat për Mac®

- Mac OS X 10.5, 10.7, 10.8 dhe 10.9
- Të paktën 256 MB RAM
- Klienti duhet të ketë hyrje të nivelit të administratorit në Mac
- Mac duhet të arrijë të lidhet me internetin

Android™

- Sistemi operativ versioni 2.3 ose i mëvonshëm (duhet të ketë të instaluar aplikacionin Google™ Play)

iOS®

- Sistemi operativ versioni 6 ose i mëvonshëm

1.2. Përpjekje e arsyeshme në aspektin tregtar.

(i) Ndërkohë që Symantec do të bëjë çdo përpjekje të arsyeshme në aspektin tregtar për kryerjen e

shërbimeve, ju dhe Symantec e kuptoni dhe e pranoni se jo të gjitha viruset mund të hiqen nëpërmjet shërbimeve dhe Symantec nuk garanton se do t'i heqë të gjitha viruset nga pajisja ose pajisjet tuaja.

(ii) gjatë kryerjes së shërbimeve, Symantec mund të përcaktojë se problemi është përtej fushës së mbulimit të shërbimeve. Symantec mund të përdorë përpjekje të arsyeshme në aspektin tregtar për t'ju drejtuar te një burim alternativ i përshtatshëm; por sidoqoftë Symantec nuk do t'ju transferojë drejtpërdrejt te një burim alternativ. Në masën e lejuar nga ligji në fuqi, Symantec ruan të drejtën të refuzojë, të pezullojë ose të ndërpresë çdo shërbim sipas gjykimit të saj të vetëm.

2. Përgjegjësitë tuaja

2.1. Përgjegjësitë bazë. Ju pranoni se jeni një mbajtës i ligjshëm i licencës së softuerit në pajisjen tuaj dhe rreziku për përdorimin e internetit nga ana juaj është vetëm përgjegjësia juaj. Duke zgjedhur që të merrni shërbimet, ju konfirmoni se (a) keni mundësi të plotë hyrjeje në harduerin dhe softuerin tuaj që janë bazë e problemit, dhe (b) keni përfunduar një rezervim në media të veçanta për çdo softuer ose të dhënë në harduer që mund të preket nga shërbimet. Të gjitha informacionet që i jepni Symantec duhet të jenë të sakta dhe të plota, duke përfshirë emrin dhe adresën tuaj, dhe nëse ka, çdo numër karte krediti ose tarifimi, datat e skadimit ose çdo informacion tjetër pagese që i keni dhënë Symantec. Ju deklaroni më tej se autorizoni Symantec të faturtojë kartën e kreditit ose të debitit (sipas rastit) që i jepni Symantec për çdo tarifë për të cilën jepni pëlqimin tuaj.

2.2. Përrjashtimi nga detyrimi. Në masën e lejuar nga ligji në fuqi, Symantec nuk do të ketë asnjë detyrim për humbjen ose rikuperimin e të dhënave, programeve, ose humbjen e përdorimit të sistemeve ose rrjeteve që lindin nga shërbimet ose çdo veprim ose heqje, duke përfshirë neglizhencën, nga ana e Symantec dhe/ose përfaqësuesve të saj. Nëse Symantec punon me ju për çdo problem me fjalëkalime ose probleme të tjera të lidhura me kontrollin e hyrjes, Symantec rekomandon shumë që t'i rivendosni menjëherë këto fjalëkalime pas përfundimit të shërbimeve.

2.3. Nuk ka transferime. Shërbimet nuk mund të transferohen. Nuk mund t'i përdorni shërbimet në lidhje me një zyrë shërbimi ose çdo organizim tjetër për shpërndarjen ose ndarjen e shërbimit, në emër të çdo pale të tretë ose në lidhje me çdo harduer ose softuer që nuk është në pronësinë tuaj personale.

3. Privatësia; Mbrojtja e të dhënave

Kur vizitoni faqen, do të zbatohet politika e privatësisë së Symantec që është e disponueshme për rishikim nëpërmjet lidhjes "Politika e privatësisë" që shfaqet në faqe.

Kur kërkonti shërbimet, informacionet e mëposhtme do të mblidhen dhe do të dërgohen nga pajisja juaj te Symantec nëpërmjet lidhjes së internetit:

- Informacionet e dhëna nga ju për përfaqësuesin e shërbimit të Symantec nëpërmjet telefonit ose të futura nga ju në ndërfaqen e internetit të Symantec kur kërkonti shërbimet; dhe
- Tipi dhe versioni i sistemit operativ dhe shfletuesit të internetit të përdorur nga pajisja juaj.

Gjatë sesionit të shërbimeve, nëse instalohet një vegël softueri për mbështetjen, mund të mblidhen informacionet e mëposhtme nga vegla e softuerit për mbështetjen dhe të dërgohen te Symantec nëpërmjet lidhjes së sigurt:

- Numri i skedarëve të skanuar, kërcënimet e gjetura dhe kërcënimet e rregulluara nga vegla e softuerit për mbështetjen;
- Tipi i kërcënimeve të gjetura;
- Numri dhe tipi i kërcënimeve të mbetura që nuk janë rregulluar nga vegla e softuerit për mbështetjen;
- Nëse një mur mbrojtës është aktiv;

- Nëse softueri antivirus është i instaluar, në ekzekutim dhe i përditësuar;
- Informacionet e shfletuesit duke përfshirë parametrat e sigurisë dhe të skedarëve të përkohshëm;
- Informacionet e sistemit në lidhje me sistemin operativ, memorien dhe hapësirën e diskut, konfigurimin e përfaqësuesit dhe listimet e direktorive për veglën e softuerit për mbështetjen;
- Statusi i sigurisë (i mirë/i pranueshëm/i dobët) për pajisjen siç përcaktohet nga vegla e softuerit për mbështetjen;
- Programet e instaluara dhe informacionet për proceset aktive; dhe
- Informacionet për skedarët e evidencave të aplikacioneve dhe të dhënat e regjistrimit.

Të gjitha informacionet e mbledhura siç përcaktohet më sipër janë të nevojshme për qëllimin e ofrimit të shërbimeve, duke përfshirë analizimin, diagnostikimin, zgjidhjen e problemit që keni hasur dhe optimizimin e funksionalitetit të produkteve dhe shërbimeve të Symantec. Informacioni mund t'i transferohet grupit Symantec në SHBA ose shteteve të tjera që mund të kenë ligje me nivel më të ulët mbrojtjeje për të dhënat sesa në rajonin ku ndodheni (duke përfshirë Bashkimin Evropian), por Symantec ka ndërmarrë hapa që informacionet e mbledhura, nëse transferohen, do të kenë një nivel të përshtatshëm mbrojtjeje.

Symantec mund t'i zbulojë informacionet e mbledhura nëse kjo gjë kërkohet nga një zyrtar i zbatimit të ligjit siç kërkohet ose lejohet nga ligji dhe në përgjigje të një thirrjeje gjyqësore ose një procesi tjetër ligjor. Për të nxitur ndërgjegjësimin, diktimin dhe parandalimin e rreziqeve të sigurisë në internet, Symantec mund të ndajë informacione të caktuara me organizata kërkimore dhe shitës të tjerë të softuerëve të sigurisë. Symantec gjithashtu mund të përdorë statistika të prejardhura nga informacioni, për gjurmimin dhe publikimin e raporteve për prirjet e rreziqeve të sigurisë.

Detajet e plota të politikës së privatësisë së Symantec mund t'i gjeni këtu:

<https://www.symantec.com/privacy>

4. Informacione të tjera të rëndësishme

4.1. Mohimi i përgjegjësisë për garancinë. NË MASËN E LEJUAR NGA LIGJI NË FUQI DHE PËRVEÇ GARANCISË NË SEKSIONIN 1.2 MË SIPËR, SYMANTEC REFUZON SHPREHIMISHT TË GJITHA DEKLARIMET E TJERA, KUSHTET DHE GARANCITË E ÇDO LLOJI, TË SHPREHURA OSE TË NËNKUPTUARA, DUKE PËRFSHIRË PA KUFIZIM ÇDO GARANCI PËR TREGTUESHMËRINË, PËRSHTATSHMËRINË PËR NJË QËLLIM TË CAKTUAR OSE MOSSHKELJEN E TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELLEKTUALE. NË MASËN E LEJUAR NGA LIGJI NË FUQI, PËRVEÇ KËSAJ SYMANTEC NUK JEP ASNJË GARANCI SE: (I) SHËRBIMET DHE/OSE FAQJA DO TË PLOTËSOJNË KËRKESAT TUAJA; (II) SHËRBIMET DHE/OSE FAQJA NUK DO TË KENË NDËRPRERJE, DO TË JENË TË SIGURTA OSE PA GABIME; (III) REZULTATET QË MUND TË MERREN NGA PËRDORIMI I SHËRBIMEVE DHE/OSE FAQJA DO TË JENË TË SAKTA OSE TË BESUESHME; (IV) CILËSIA E ÇDO SHËRBIMI, ABONIMI, PRODUKTI OSE INFORMACIONI TË BLERË OSE TË MARRË NGA JU NËPËRMJET SHËRBIMEVE DHE/OSE FAQES DO TË PLOTËSOJNË PRITSHMËRITË TUAJA; (V) ÇDO GABIM NË SHËRBIME DHE/OSE FAQE DO TË KORRIGJOHET; (VI) TË GJITHA VIRUSET DO TË HIQEN NËPËRMJET SHËRBIMEVE; OSE (VII) NË LIDHJE ME PAGESËN E RIMBURSIMIT, KOHA E NJË PAGESE TË TILLË DO TË PËRMBUSHË PRITSHMËRITË TUAJA. ÇDO VEGËL SOFTUERI PËR MBËSHTETJEN, MATERIAL DHE/OSE E DHËNË E SHKARKUAR OSE E MARRË NË NJË MËNYRË TJETËR NËPËRMJET PËRDORIMIT TË SHËRBIMEVE BËHET ME PËLQIMIN DHE RREZIKUN TUAJ. VEGLA E SOFTUERIT PËR MBËSHTETJEN OFROHET "SIÇ ËSHTË", DUKE PËRJASHTUAR ÇDO GARANCI DHE OFROHET NË PËRPUTHJE ME MARRËVESHJEN E PËRDORIMIT PËR VEGLËN E SOFTUERIT PËR MBËSHTETJEN. SYMANTEC NUK JEP GARANCI PËR PRODUKTE TË PALËVE TË TRETA.

4.2. Kufizimi i detyrimit. DISA SHTETE DHE JURIDIKSIONE, DUKE PËRFSHIRË SHTETET ANËTARE TË ZONËS EKONOMIKE EVROPIANE, NUK LEJOJNË KUFIZIMIN OSE PËRJASHTIMIN E DETYRIMIT PËR DËME AKSIDENTALE OSE RRJEDHIMORE, KËSHTU QË KUFIZIMI OSE PËRJASHTIMI I MËPOSHTËM MUND TË MOS JETË I VLEFSHËM PËR JU.

NË MASËN MAKSIMALE TË LEJUAR NGA LEGJISLACIONI NË FUQI DHE PAVARËSISHT NËSE ÇDO DËMSPËRBLIM I PËRCAKTUAR KËTU NUK ARRIN TË REALIZOJË QËLLIMIN E TIJ BAZË, NË ASNJË RAST SYMANTEC NUK DO TË JETË PËRGJEGJËS NDAJ JUSH PËR (A) ÇDO HUMBJE FITIMESH OSE TË DHËNASH QË LIND NGA OFRIMI I SHËRBIMEVE, (B) ÇDO HUMBJE PËRDORIMI OSE MUNGESË DISPONUESHMËRIE PËR PAJISJET KOMPJUTERIKE, MESAZHE TË DËSHTUARA OSE GABIME TRANSMETIMI QË LINDIN NGA PËRDORIMI OSE PAAFTËSIA PËR TË PËRDORUR SHËRBIMET, OSE (C) ÇDO HUMBJE OSE DËM I VEÇANTË, RRJEDHIMOR, INDIRECT OSE I NGJASHËM, EDHE NËSE SYMANTEC ËSHTË KËSHILLUAR PËR MUNDËSINË E NJË HUMBJEJE OSE DËMI TË TILLË. NË ASNJË RAST DETYRIMI I SYMANTEC NUK DO TË KALOJË MAKSIMUMIN E ÇMIMIT QË KENI PAGUAR PËR SHËRBIMET OSE PESËDHJETË DOLLARË (50,00 \$) OSE SHUMËN E BARASVLERSHME NË VALUTËN PËRKATËSE.

4.3. Të drejtat e pronësisë. Symantec ruan pronësinë për të gjitha të drejtat e pronësisë për shërbimet, faqen, veglën e softuerit për mbështetjen dhe për të gjithë emrat tregtarë, markat tregtare dhe markat e shërbimit të lidhura ose të shfaqura me shërbimet. Ju nuk do të hiqni, dëmtoni ose fshihni asnjë nga njoftimet e të drejtave të autorit ose markave tregtare të Symantec dhe/ose legjendat ose njoftime të tjera të pronësisë, të përfshira aty, ose të lidhura me shërbimet. Nuk mund të shprogramoni, dekompononi ose të zbërtheni në formën e lexueshme nga njeriu asnjë vegël softueri të mbështetjes në lidhje me shërbimet.

4.4. Forca madhore. Në masën maksimale të lejuar nga ligji në fuqi, Symantec nuk do të jetë përgjegjëse për asnjë dështim në veprime për shkak të rrethanave të paparashikuara ose për shkaqe jashtë kontrollit të arsyeshëm të Symantec, duke përfshirë, por pa u kufizuar me veprat e Zotit, lufta (e deklaruar apo jo), revolta, embargo, veprime të autoriteteve civile ose ushtarake, sulm terrorist ose kërcënim për sulm terrorist, zjarr, përmbytje, aksidente, greva, ndërprerje pune, dështime të infrastrukturës dhe rrjeteve publike ose private të telekomunikacioneve ose ndërprerje të transportit, shërbimeve, karburantit, energjisë, punës ose materialeve. Në rast të një vonese të tillë, Symantec mund të justifikohet për një performancë të tillë për sa kohë që vonohet ose pengohet nga një shkak i tillë.

4.5. Rregullorja e eksportimit. Ju pranoni se shërbimet, vegla e softuerit për mbështetjen dhe shërbimet dhe të dhënat përkatëse teknike (të gjitha së bashku këtu "teknologji e kontrolluar") mund t'u nënshtrohen ligjeve për import-eksportin të SHBA-së, veçanërisht rregulloreve për administrimin e eksportit të SHBA-së (EAR), dhe ligjeve të cilido shteti ku importohet apo rieksporthet teknologjia e kontrolluar. Ju bini dakord të pajtoheni me të gjitha ligjet përkatëse dhe të mos eksportoni ndonjë teknologji të kontrolluar në shkelje të legjislacionit të SHBA-së, as të ndonjë shteti, subjekti apo personi të ndaluar për të cilat kërkohet licencë eksporti apo miratim qeveritar në formë tjetër. Të gjitha abonimet e Norton ndalohen të eksportohen apo të rieksporthen në Kubë, Kore të Veriut, Iran, Siri dhe Sudan dhe drejt çdo shteti që është objekt i sanksioneve përkatëse tregtare. Ju pranoni këtu se nuk do të eksportoni apo shitni asnjë teknologji të kontrolluar për përdorim në lidhje me armë kimike, biologjike ose nukleare, ose raketa, drone ose mjete të lëshimit hapësinor të afta për dërgimin e armëve të tilla.

5. Të përgjithshme

A. Ligji rregullator. Kushtet do të rregullohen nga ligjet e Anglisë dhe të Uellsit. Asgjë në këto kushte nuk i pakëson të drejtat që mund të gëzoni sipas legjislacionit ekzistues për mbrojtjen e konsumatorit apo ligje të tjera në fuqi në juridiksionin tuaj që nuk tërhiqen me kontratë.

B. Marrëveshja e plotë. Kushtet përbëjnë të gjithë marrëveshjen midis jush dhe Symantec në lidhje me shërbimet dhe: (i) tejkalojnë të gjitha komunikimet, propozimet dhe deklaratat e mëparshme apo aktuale verbale apo me shkrim, në lidhje me çështjen në fjalë; dhe (ii) mbizotërojnë ndaj çdo kushti konfliktual apo shtesë për çmime, porosi, pranime apo komunikime të ngjashme midis palëve. Kushtet do të ndërpriten menjëherë në rast të shkeljes së kushteve nga ana juaj, duke përfshirë por jo kufizuar në: shkeljen e përgjegjësisë tuaja bazë, duke përfshirë detyrimet për pagesën dhe mostransferimin, sipas Seksionit 2,1 ose 2,3 këtu, dhe/ose shkeljen e të drejtave të pronësisë së Symantec, ose ligjeve në fuqi për importimin dhe eksportimin sipas Seksioneve 4.3 ose 4.5 këtu, si dhe do të ndërpriteni menjëherë përdorimin e shërbimeve. Mohimet e përgjegjësisë për garancitë dhe dëmtimet si dhe kufizimet për detyrimin të përcaktuara te kushtet vazhdojnë të mbeten në fuqi edhe pas përfundimit. Nëse keni ndonjë pyetje në lidhje me këto kushte ose nëse dëshironi të kontaktoni me Symantec për çfarëdo arsye, shkruani te (i) Symantec Customer Support, PO Box 5689, Dublin 15, Ireland. vizitoni faqen e mbështetjes për shtetin ose rajonin tuaj, që mund të ndodhet në <https://www.symantec.com/globalsites/>. Symantec nuk do të paraqesë një kopje të kushteve.

IE VPP Terms/estore ACQ 6.0.2